

MANUAL PËR VËZHGESIT VENDORË TË ZGJEDHJEVE

MANUAL PËR VËZHGUËSIT VENDORË TË ZGJEDHJEVE



VLERËSIMI I ZGJEDHJEVE

1

PËRGATITJA E NJË PROGRAMI VËZHGIMI

2

ANALIZA E LEGJILACIONIT

3

MONITORIMI I MOSMARRËVESHJEVE ZGJEDHORE

4

VLERËSIMI I REGJISTRIMIT TË ZGJEDHËSVE
DHE KUFIJTË E RRETHEVE ZGJEDHORE

5

MONITORIMI I ADMINISTRATËS ZGJEDHORE

6

MONITORIMI I REGJISTRIMIT TE KANDIDATËVE
& PARTIVE POLITIKE

7

MONITORIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE

8

MONITORIMI I MEDIAS

9

VËZHGIMI I VOTIMIT DHE I NUMËRIMIT TË VOTAVE

10

MONITORIMI I NXJERRJES SË REZULTATEVE,
TRANSMETIMIT DHE SHPALLJES SË REZULTATEVE

11

RAPORTIMI DHE REKOMANDIMET

12

6. MONITORIMI I ADMINISTRATËS ZGJEDHORE64
A. Struktura E Administratës Zgjedhore65
B. Vlerësimi I Cilësisë Dhe Saktësisë Së Regjistrimit /Listave Të Zgjedhëseve ..	.66
7. MONITORIMI I RREGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE & PARTIVE POLITIKE .70	
A. Regjistrimi I Partive Politike71
B. Regjistrimi I Konkurruesve Politikë72
C. Regjistrimi I Grave Dhe Pakicave Kombëtare73
8. MONITORIMI I FUSHATËS ZGJEDHORE74
A. Takimet Me Partitë Politike Dhe Kandidatët76
B. Takimet Me Mediat77
C. Takimet Me Zyrtarët Publikë77
D. Monitorimi I Ngjarjeve Gjatë Fushatës78
E. Monitorimi I Sjelljes Së Forcave Të Sigurimit79
F. Monitorimi I Shpenzimeve Për Fushatën, Burimeve Dhe Sasisë Së Donacioneve .79	
G. Monitorimi I Keqpërdorimit Të Burimeve Shtetërore82
H. Parandalimi I Konfliktëve Dhe Monitorimi I Dhunës Në Zgjedhje83
I. Monitorimi I Çështjeve Të Tjera85
9. MONITORIMI I MJETEVE TË INFORMACIONIT88
A. Rëndësia E Monitorimit Të Mjeteve Të Informacionit89
B. Qëllimi I Monitorimit Të Mjeteve Të Informacionit90
C. Vlerësimi I Kuadrit Ligjor Që Rregullon Mjetet E Informacionit91
D. Monitorimi I Operatorëve Radiotelevizive Dhe I Medias Së Shkruar ..	.91
E. Monitorimi I Reklamës Politike Me Pagesë Dhe Informimi I Zgjedhësve .97	
F. Monitorimi I Kërcënimeve Ndaj Mjeteve Të Informacionit Dhe Gazetarëve .97	
10. VËZHGIMI I VOTIMIT DHE NUMËRIMI I VOTAVE98
A. Vëzhgimi I Votimit Dhe I Numërimit Të Votave100
B. Nxjerrja Paralele E Rezultatit Të Zgjedhjeve106
11. MONITORIMI, NXJERRJA, REGJISTRIMI NË KOMPJUTER DHE DEKLARIMI	
I REZULTATEVE110
A. Rëndësia E Monitorimit Të Nxjerrjes Së Rezultateve111
B. Monitorimi I Regjistrimit Të Rezultateve Në Kompjuter112
C. Monitorimi I Zhvillimeve Pas Ditës Së Zgjedhjeve112
12. RAPORTIMI DHE REKOMANDIMET114
A. Rëndësia E Raportimit115
B. Raportimi Nga Monitoruesit Rajonalë116
C. Raportimi Për Incidente118
D. Deklaratat118
E. Raporti Përfundimtar120
F. Shpërndarja E Raportit121
RRETH OSBE/ODIHR122

FALËNDERIME

Në përgatitjen e këtij manuali morën pjesë grupe vëzhguesish vendorë nga i gjithë rajoni i OSBE-së. Ai u konceptua në një mbledhje pune me grupet drejtuese në Sllovaki në Maj, 2001 dhe u zhvillua më tej në një konferencë të OSBE/ODIHR në Varshavë ku morrën pjesë rreth 25 grupe vëzhguesish vendorë në fund të muajit Maj.

ODIHR do të dëshironte t'i shprehte vlerësimin e tij për Simon Osborn-it (Drejtor Ekzekutiv i Shërbimeve Ndërkombëtare për Reformën Zgjedhore), i cili sëbashku me Seksionin e ODIHR-it për Zgjedhjet u ngarkuan për hartimin e këtij manuali. ODIHR u është mirënjohës gjithashtu Mark Stevens-it, Paul O'Grady-t, Jessie Pilgrim-it dhe Peter Eicher-it, të cilët kanë kontribuar në mënyrë të konsiderueshme për hartimin e këtij teksti. Së fundmi, ODIHR do të dëshironte të falenderonte Institutin Demokratik Kombëtar për Çështjet Ndërkombëtare (NDI) për mbështjetjen që ka dhënë gjatë gjithë përgatitjes së manualit dhe në veçanti për lejin e ODIHR-it të përdorë materiale nga botimet e NDI-s. Një vlerësim i veçantë i bëhet gjithashtu edhe ndihmës së Holly Ruthrauff-it.

Metodat e përcaktuara nuk janë as shteruese e as ekskluzive; ato duhet të shërbejnë më shumë si instrumente në duart e grupeve të vëzhguesve vendorë. Qëllimi nuk është të jepet një metodologji përfundimtare që duhet ndjekur, por më shumë synohet në përcaktimin e metodologjive të ndërtuara dhe të përdorura me efektivitet gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, si nga vëzhguesit ndërkombëtarë, ashtu dhe nga vëzhguesit vendorë. Mbi këtë bazë, ky manual mund të jetë i vlefshëm si për organizatat ndërkombëtare që angazhohen me vëzhgimin e zgjedhjeve, ashtu edhe për vëzhguesit e partive politike dhe kandidatëve, të cilët luajnë një rol po aq të rëndësishëm në monitorimin e zgjedhjeve. E ndërkohë që teknikat për vëzhgimin e zgjedhjeve përparojnë, e njejtat gjithë ndodh edhe me qasjen ndaj monitorimit të zgjedhjeve. Shpresohet se me grumbullimin e përvojës vëzhguese, mësimet e nxjerra do të ndahen midis vëzhguesve ndërkombëtarë dhe vendorë, si brenda ashtu dhe jashtë rajonit të OSBE-së.

Manuali është përgatitur në bashkëpunim me më shumë se 20 grupe vëzhguesish vendorë në rajonin e OSBE-së dhe pasqyron përvojën e grupeve të vëzhguesve vendorë në vende të tjera të botës. Përveç kësaj, manuali bazohet edhe në përvojën e OSBE/ODIHR dhe organizatave të tjera ndërkombëtare që janë angazhuar në vëzhgimin e zgjedhjeve, në veçanti Instituti Demokratik Kombëtar për Çështje Ndërkombëtare (NDI) dhe Shërbimet Ndërkombëtare për Reformën Zgjedhore (ERIS) dhe përmban materiale nga botimet e OSBE/ODIHR dhe NDI. Një udhëzues tjetër i botuar nga NDI me titull “Si i Monitorojnë Zgjedhjet Organizatat Vendorë: Një Udhëzues nga A në Z” është një burim veçanërisht i dobishëm për t’u konsultuar nga grupet vëzhguese vendorë dhe mund të përdoret krahas këtij manuali.

- ➔ Vlerësoni zgjedhjet në përputhje me angazhimet ndërkombëtare të një vendi dhe me kuadrin e brendshëm ligjor
- ➔ Kushtojini vemendje të veçantë Angazhimeve të OSBE-së për zgjedhje demokratike që përfshihen në “Dokumentin e Kopenhagenit” të vitit 1990
- ➔ Gjykoni shkallën e përmirësimit të zgjedhjeve në krahasim me zgjedhjen e mëparshme

A. STANDARTET NDËRKOMBËTARE PËR ZGJEDHJET DHE TË DREJTAT E NJERIUT¹

Roli themelor që luajnë zgjedhjet transparente dhe të hapura në sigurimin e të drejtës universale dhe themelore për qeverisje demokratike pjesëmarrëse dhe respektimi i të drejtave politike mishërohen në një numër dokumentesh ndërkombëtare të zbatueshme në Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së. Më i rëndësishmi është Neni 21 i Deklaratës Universalë të të Drejtave të Njeriut,² ku thuhet:

DEKLARATA UNIVERSALE E TË DREJTAVE TË NJERIUT, NENI 21

1. KUSHDO KA TË DREJTË TË MARRË PJESE NË QEVERINË E VENDIT TË TIJ, DREJTPËRDREJT APO NËPËRMJET PËRFAQËSUESVE TË ZGJEDHUR LIRISHT.
2. KUSHDO KA TË DREJTËN E AKSESIT TË BARABARTË NË SHËRBIMET PUBLIKE TË VENDIT TË TIJ.
3. VULLNETI I POPULLIT ËSHTË THEMELI I AUTORITETIT TË QEVERISË; KY VULLNET DUHET TË SHPREHET NË ZGJEDHJE PERIODIKE DHE TË NDRERSHME, TË CILAT DUHET TË BAZOHEN NË TË DREJTËN UNIVERSALE DHE TË BARABARTË TË VOTËS E QË REALIZOHET ME VOTIM TË FSHEHTË APO PROCEDURA TË BARAZVLEFSHME QË SIGUROJNË LIRINË E VOTËS.

¹ Për një analizë më të thellë të normave ndërkombëtare që lidhen me zgjedhjet demokratike në rajonin e OSBE-së, shih Existing Commitments for Democratic Elections in OSCE Participating States: A Progress Report. Ky dhe dokumenta të tjerë të dobishëm mund të gjenden në faqen e Internetit të OSBE/ODIHR në <http://www.osce.org/odihr/elections/standards>.

² Teksti i plotë i Deklaratës për të Drejtat e Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, dhe standarte të tjera të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut mund të gjenden në faqen e Internetit të Komisionit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në adresën <http://www.unhcr.ch>.

Mbrojtja e pakicave kombëtare dhe e të drejtave të barabarta politike të anëtarëve të pakicave përfshihet në shumë instrumenta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ato kanë marrë një vëmendje gjithnjë e më të madhe dhe janë trajtuar nga standarte të tilla ndërkombëtare si Konventa e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Dallimit Racial (Neni 2); Deklarata e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave që u Përkasin Pakicave Kombëtare, Etnike, Fetare apo Gjuhësore (Neni 2); Konventa Kuadër e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (Neni 5); dhe Dokumenti i Moskës i OSBE-së. Këto standarte janë përpunuar më tej në Rekomandimet Lund mbi Pjesëmarrjen e Efektshme të Pakicave Kombëtare në Jetën Publike.⁵

Në mënyrë domethënëse, Paragrafi 8 i Dokumentit të Kopenhagenit justifikon rolin që luajnë vëzhguesit ndërkombëtarë dhe vendorë në rajonin e OSBE-së, duke deklaruar se “prania e vëzhguesve, si të huaj ashtu dhe vendorë, mund të rrisë integritetin e procesit zgjedhor.” Paragrafi 10 mbështet të drejtën e organizatave qytetare të kenë “akses dhe komunikim me organet e ngjashme brenda dhe jashtë vendeve të tyre dhe me organizata ndërkombëtare” dhe të “kërkojnë, të marrin dhe të përdorin....kontributet financiare që sigurohen nga burime kombëtare dhe ndërkombëtare....” Më tej, në Paragrafin 12, Shtetet pjesëmarrëse “vendosin të pranojnë si një masë që rrit besimin, praninë e.....përfaqësuesve të organizatave jo-qeveritare.....në seancat gjyqësore.”

⁵ Rekomandimet Lund-it u hartuan në 1999 nga një grup ekspertësh të autorizuar nga Komisioneri i Lartë i OSBE-së për Pakicat Kombëtare. Për më shumë hollësi, shih *The origin and nature of the Lund Recommendations on the Effective Participation of National Minorities in Public Life*, Helsinki Monitor, Volumi II, Nr.4,2000. Në 2001, ODIHR botoi *Guidelines to Assist National Minority Participation in the Electoral Process*, të cilat mund të gjenden në adresën http://www.osce.org/odihr/documents/guidelines/gl_nmpa_eng.pdf.

→ **Zgjedhje periodike** do të thotë zgjedhje që mbahen në intervale të rregullta kohore, siç e përcakton ligji. Intervali kohor midis dy zgjedhjeve duhet të ketë një kohëzgjatje të arsyeshme. Shtatë vjet konsiderohet normalisht si periudha maksimale kohore e arsyeshme midis zgjedhjeve për organin më të lartë ekzekutiv; pesë vjet konsiderohet normalisht periudha maksimale për dhomat më të ulëta të parlamentit. Zyrtarët e degës ekzekutive të qeverisë nuk duhet të zgjidhen për jetë.

→ **Zgjedhjet e vërteta** nënkuptojnë në thelb mundësinë e votuesve për të bërë zgjedhjen e tyre të vërtetë dhe pasqyrojnë të drejtën e popullit për të ndryshuar qeverinë e tij. Në rast se nuk ka kandidatë të besueshëm opozitarë, kufizime të paarsyeshme në lidhje me formimin apo etikën e partive politike apo kandidatëve, apo kur nuk ka një parashikim të arsyeshëm se zgjedhësit do të kenë forcën për të votuar kandidatët që nuk kanë poste, atëherë ligjshmëria e zgjedhjeve vihet në pikëpyetje.

→ **Zgjedhje të lira** do të thotë që të drejtat e njeriut dhe liritë themelore respektohen para, gjatë dhe pas zgjedhjeve. Të gjithë qytetarët, partitë, dhe kandidatët duhet të gëzojnë lirinë e shprehjes, organizimit, tubimit dhe lëvizjes. Gjatë procesit zgjedhor nuk duhet të ketë kërcënime, dhunë, ndërhyrje administrative apo frikë për ndëshkim. Media duhet të jetë në gjendje të mbulojë lirisht fushatën, dhe organizatat e shoqërisë civile duhet të jenë të lira të ndërmarrin veprimtari që lidhen me zgjedhjet. Për shembull, vëzhguesit vendorë duhet të lejohen të monitorojnë votimin dhe numërimin e votave, dhe rezultatet e nxjerra duhet të afishohen në një vend të dukshëm dhe të jenë të verifikueshme nga niveli i qendrës së votimit, në nivelet ndërmjetëse të administratës zgjedhore, deri në nivelin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

→ **Zgjedhjet e ndershme** duhet të sigurojnë një fushë të barabartë veprimi për konkurruesit, me trajtim të barabartë përpara ligjit dhe nga autoritetet. Ligjet nuk duhet të jenë diskriminuese dhe duhet të zbatohen me ndershmëri. Të gjithë kandidatët të cilët duan të marrin pjesë në garë, duhet të lejohen ta ndërmarrin këtë veprim. Burimet publike nuk duhet të përdoren në mënyrë të padrejtë. Media publike duhet të jetë e paanashme. Administrata zgjedhore duhet të veprojë në mënyrë të paanshme. Votimi, numërimi dhe nxjerrja e rezultateve duhet të kryhen pa mashtrime. Kandidatët që sigurojnë numrin e kërkuar të votave duhet të vendosen në postet përkatëse. Kandidatët dhe zgjedhësit duhet të kenë akses për zgjidhjen e kërkesave të tyre ankimore në një organ të pavarur gjyqësor. Personat që ngarkohen me përgjegjësi për shkeljet e ligjit duhet të përgjigjen.

D. KRAHASIMI ME ZGJEDHJET E MËPARSHME

Në vlerësimin e një procesi zgjedhor, vëzhguesit vendorë mund të marrin në considerate edhe shkallën e përmirësimit në krahasim me zgjedhjet e mëparshme. Kjo mund të bëhet duke iu referuar raporteve të mëparshme të botuara nga organizata ndërkombëtare dhe grupe vëzhguesish vendorë. Raportet e vëzhgimit të zgjedhjeve të OSBE/ODIHR mund të gjenden në faqen e internetit në adresën <http://www.osce.org/odihr>.

- Përcaktoni çështjet kryesore për shqyrtim dhe vlerësim
- Përcaktoni burimet njerëzore dhe financiare që disponohen
- Trajtoni planifikimin dhe çështjet institucionale para se të filloni veprimet
- Ndërtoni një program dhe strukturë organizative duke u bazuar në situatën zgjedhore dhe politike dhe në burimet njerëzore e financiare në dispozicion
- Zhvilloni kapacitetet për zbatimin e programit
- Sigurohuni për paanshmëri dhe respektim të një kodi të sjelljes

A. VLERËSIMI I NEVOJAVE

Meqenëse zgjedhjet nuk janë ngjarje që zgjasin vetëm një ditë, grupi i vëzhguesve vendorë duhet të planifikojë veprimet shumë kohë para ditës së zgjedhjeve. Legjislacioni i brendshëm mbi zgjedhjet duhet të analizohet thellësisht për të parë nëse ka ndonjë kufizim për grupet e vëzhguesve vendorë që angazhohen në vëzhgimin e zgjedhjeve. Masat kufizuese mund të përfshijnë nevojën për t'u regjistruar pranë autoriteteve përkatëse në mënyrë që veprimtaritë që lidhen me vëzhgimin vendor të zgjedhjeve, të përfshihen në statutin e grupit, si dhe moslejimin e grupeve të vëzhguesve vendorë të marrin fonde nga organizata të huaja. Analiza e legjislacionit duhet të vlerësojë gjithashtu implikimet praktike në lidhje me procedurat për të kërkuar dhe fituar akreditimin apo mandatin e vëzhguesit. Vendimi për të formuar ose jo një shoqatë të organizatave të shoqërisë civile për vëzhgimin e zgjedhjeve mund të bazohet gjithashtu në aspektet e veçanta të legjislacionit kombëtar dhe rrjedhimet e tij. Këto çështje kanë një vlerë jetike dhe mund të jenë vendimtare për kryerjen e një operacioni vëzhgues për zgjedhjet. Prandaj, koha paraprake e nevojshme për të plotësuar kërkesat e legjislacionit dhe për të siguruar fondet e mjaftueshme, mund të jetë deri në një vit ose dhe më shumë se një vit.

këshillueshme që ata të caktohen sipas strukturës së komisioneve të zgjedhjeve, në mënyrë që çdo njësi të ketë nën përgjegjësinë e saj një territor zgjedhor që i korrespondon një rajoni administrativ apo një grupi rrethesh zgjedhore ose madje një zone zgjedhore. Sistemi zgjedhor mund të bazohet në përfaqësimin proporcional ose në zona zgjedhore një-emërore/shumë-emërore ose me kombinimin e të dyjave. Zgjedhjet mund të jene me një ose dy raunde. Këto janë ndryshime të rëndësishme. Për shembull, gjatë zgjedhjeve parlamentare, bazuar në sistemin e listave zgjedhore, vëzhguesit nuk do të jenë në gjendje të vëzhgojnë regjistrimin e kandidatit dhe në këtë rast del më shumë në pah një fushatë zgjedhore kombëtare, se sa kur kemi të bëjmë me një sistem zonash zgjedhore. Në të kundërt, për zgjedhjet parlamentare që përdorin sistemin maxhoritar të bazuar në zona zgjedhore, apo për zgjedhjet e qeverisjes vendore, vëzhguesit mund të kenë mundësinë për të ndjekur shumë gara të veçanta zgjedhore në të njëjtën kohë. Këto faktorë duhen marrë në konsideratë gjatë vlerësimit të nevojave, pasi ato do të kenë një peshë të madhe në përcaktimin e metodologjisë së vëzhgimit. Në disa lloje zgjedhjesh, mund të mos jetë e mundur të mbulohet efektivisht i gjithë territori, dhe kështu dislokimi i vëzhguesve mund të bëhet në një territor zgjedhor të marrë si model, apo mund të kufizohet në një rajon të vetëm.

Një tjetër konsideratë e fundit është nëse grupi i vëzhguesve vendorë duhet të angazhohet në veprimtari të tjera që lidhen me zgjedhjet, siç mund të jenë informimi publik ose fushatat sensibilizuese për rëndësinë e votimit, apo çdo formë tjetër asistence për autoritetet zgjedhore apo shtetërore. Këto çështje duhen trajtuar me kujdes edhe për sa i përket mundësisë për konflikt interesi me thelbin e veprimtarive vëzhguese, pasi ndonjëherë është e vështirë të bëhet një ndarje e qartë midis vëzhgimit të procesit dhe të qenurit aktor në proces.

B. PLANIFIKIMI DHE ÇËSHTJET INSTITUCIONALE⁷

Kur formulojmë shtrirjen, shkallën dhe kohën e veprimtarive vëzhguese, duhet të bëjmë një vlerësim real të burimeve njerëzore dhe financiare që disponojmë. Një grup vëzhguesish vendorë mund të jetë një organizatë e vetme apo një shoqatë a rrjet organizatash të shoqërisë civile. Secili model mund të aplikohet me efektivitet dhe të dy mund të përdoren brenda dhe jashtë rajonit të OSBE-së.

Çështje që lidhen me rekrutimin e personel

Kur një organizatë e caktuar e shoqërisë civile apo një shoqatë e organizatave të shoqërisë civile vendos të ndërmarrë një vëzhgim zgjedhor, përsëri do të jetë e nevojshme të rekrutohet personel i ri. Çështjet dhe problemet kryesore në lidhje me këtë janë:

⁷ Manuali i NDI-së Si i Monitorojnë Zgjedhjet Organizatat Vendorë: Një Guidë A-Z, botuar më 1995, jep më shumë hollësiira mbi ndërtimin e një programi dhe grupi vëzhguesish vendorë.

të jenë të disponueshëm për detyrat e ngarkuara. Angazhimi për të shërbyer si vëzhgues duhet të jetë një mundësi e hapur për një masë të madhe të shoqërisë.

Kur rekrutohet personel i ri apo vullnetarë, grupi i vëzhguesve vendorë duhet të përpiqet, sa të mundet, të sigurojë brenda grupit një ekuilibër në lidhje me gjininë, moshën, përkatësinë etnike apo gjuhën. Menjëherë pas rekrutimit, vëzhguesve dhe monitoruesve racionalë duhet t'u bëhet një përgatitje e gjithanshme. Duhet menduar dhënia e kopjeve të materialeve të trainimit strukturave të tjera si p.sh. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me qëllim që të sigurohet transparenca. Kur përcaktojmë praninë e vëzhguesve, një grup vendor duhet të vlerësojë avantazhin e vendosjes së vëzhguesve në zonën e tyre të banimit dhe të sigurohemi se janë krijuar të gjitha kushtet që vëzhguesit të votojnë.

Cështje institucionale

Avantazhi i një organizate të vetme është se menaxhimi dhe vendim-marrja realizohen më lehtë se sa nga një grupim organizatash. Nga ana e tjetër, grupimi mund të përmbajë organizata të shoqërisë civile me ekspertizë të veçantë të një fushe të caktuar, p.sh. në monitorimin e shtypit, ose me prezencë të gjatë në një rajon të caktuar, duke forcuar kështu kapacitetin dhe profesionalizmin vëzhgues. Çdo grupim duhet të ketë bazë sa më të gjerë. Një grupim organizatash të respektuara të shoqërisë civile mund të jetë më i besueshëm se sa një organizatë e vetme, veçanërisht kur shumë organizata vëzhguese vendore operojnë dhe konkurrojnë në të njëjtën kohë për mbulimin mediatik. Në përgjithësi, grupet e vëzhguesve vendorë duhet të shmangin kryerjen e veprimtarive të njëjta me ato të organizatave të tjera të shoqërisë civile, me përjashtim të rrethanave të veçanta dhe duhet ta kenë parasysh se donatorët ndërkombëtarë nuk do të financonin veprimtari të reja vëzhgimi atje ku operon ndërkohë një organizatë e besueshme. Në të tilla raste, objektivi duhet të jetë rritja e bashkëveprimit me veprimtari të reja dhe shtimi i vlerave të veprimtarive që janë në realizim e sipër.


Për të siguruar marrëdhënie sa më të mira midis anëtarëve të grupimit është e këshillueshme të hartohet një marrëveshje grupimi mes tyre, e cila duhet nënshkruar nga të gjithë përfaqësuesit e autorizuar të organizatave të shoqërisë civile të përfshira në të. Për të lehtësuar vendimmarrjen konsensuale, zgjidhjen e çështjeve institucionale, dhe për të rritur transparençën në raportimin financiar, shoqata mund të shqyrtojë mundësinë e krijimit të një bordi apo komiteti drejtorësh me persona të emëruar dhe zgjedhur në postet t rëndësishme. Megjithatë, administrimi i përditshëm i operacioneve duhet të kryhet nga Njësia Editoriale dhe Menxhuese. (shih më poshtë).

se ai ka kapacitetin e duhur për të thithur financimin për projektin si dhe përpjekjet për pakësimin e kostove ku të jetë e mundur.

Donatorët do të duan të sigurojnë korrektesë financiare. Kështu, kontrollet e mjaftueshëm financiarë dhe kapaciteti për të përgatitur raportet e duhura financiare kanë një rëndësi të jashtzakonshme. Me krijimin e një konsorciumi të organizatave të shoqërisë civile duhet të hapet edhe nje llogari bankare e veçantë. Megjithatë, vendime të tilla duhet të kryhen në bazë të një marrëveshjeje të shoqatës, statuteve të organizatave të shoqërisë civile, dhe legjislacionit e rregullave administrative vendase përkatëse.

C. STRUKTURA DHE FUNKSIONET E PROGRAMIT

Sapo një grup vëzhguesish vendorë ka vendosur se çfarë mund të vëzhgojë ai në mënyrë realiste, ai duhet të shqyrtojë strukturën organizative më të efektshme. Përvoja tregon se një strukturë vëzhguese duhet të përfshijë tri elementë: ❶ një njësi që kontrollon menaxhimin e programit dhe nxjerr raporte dhe deklarata për shtyp; ❷ një njësi që ndërmer koordinimin dhe analizën; dhe ❸ një njësi për administrim, përfshij këtu financën, logjistikën dhe trainimin.



MODEL I STRUKTURËS SE VËZHGIMIT VENDOR TË ZGJEDHJEVE

- **Fushata:** përfshin kontaktin me partitë politike dhe ekipet e fushatës së kandidatëve dhe monitorimin e vlerësimin e çështjeve që lidhen me lirinë e organizimit, tubimimit dhe shprehjes, si dhe barazinë dhe ndershmërinë e klimës gjatë fushatës;
- **Pakicat Kombëtare:** përfshin kontaktin me përfaqësuesit e pakicave kombëtare dhe të institucioneve qeveritare e organizatave të shoqërisë civile që kanë lidhje me to, si dhe monitorimin e vlerësimin e pjesëmarrjes së pakicave kombëtare në procesin zgjedhor;
- **Ë Gjinia:** përfshin kontaktin me institucionet qeveritare dhe organizatat joqeveritare që tregojnë interes për krijimin e mundësive të barabarta dhe monitorojnë e vlerësojnë pjesëmarrjen e grave në procesin zgjedhor, si dhe mbulojnë çështje me interes për gratë;
- **Ë Koordinimi i Monitoruesve Rajonalë:** përfshin dhënien e udhëzimeve dhe orientimeve drejtuese, si dhe marrjen e analizimin e raporteve nga rajonet.

Njësia duhet të ketë në stafin e saj persona me përvojën e duhur, p.sh. anëtarë me njohuri nga fusha e ligjeve. Njësia duhet të përfshijë në stafin e saj ekspertë statistikash të cilët do të ngarkohen me përmirësimin e mjeteve të vlerësimit statistikor dhe me krahasimin, futjen dhe analizimin e informacionit sasior.

3 NJËSIA E ADMINISTRIMIT DHE TRAINIMIT

Kjo njësi duhet të përgjigjet për të gjitha aspektet e administratës, përfshirë përgatitjen e llogarive dhe buxheteve, rekrutimin e vullnetarëve dhe ruajtjen në kompjuter të informacionit për vullnetarët. Në bashkëpunim me Njësinë e Vëzhgimit, Koordinimit dhe Analizës, kjo njësi duhet të kryejë gjithashtu koordinimin e trainimit, bashkë me përpunimin e materialeve, rekrutimin e trainuesve, dhe zhvillimin e vlerësimin e trainimit për stafin dhe vullnetarët në të gjitha nivelet.

Trainimi për anëtarët e Njësisë Editoriale dhe Menaxhuese dhe të Njësisë së Vëzhgimit, Koordinimit dhe Analizës duhet të jetë i një standarti shumë të lartë. Në rast se ekzistojnë kapacitete vendase që mund ta kryejnë këtë detyrë, atëherë kjo mundësi duhet shfrytëzuar; përndryshe, një grup vëzhguesish vendorë duhet të shqyrtojë mundësinë e marrjes së ekspertizës ndërkombëtare ose nga një grup vëzhguesish vendorë të një shteti tjetër që ka përvojë në vëzhgimin e zgjedhjeve ose nga një organizatë apo OJF ndërkombëtare që ka ekspertizë në këtë fushë. Menjëherë pas trainimit, anëtarët e Njësisë Editoriale dhe Menaxhuese dhe të Njësisë së Vëzhgimit, Koordinimit dhe Analizës mund të angazhohen në trainimin e personelit dhe të vëzhguesve në nivel rajonal dhe lokal.

F. PAANSHMËRIA

Është e rëndësishme që një grup vëzhguesish vendorë të bëjë të gjitha përpjekjet për të garantuar se ai zhvillon veprimtari të paanshme. Si grupi në tërësi ashtu dhe vëzhguesit si individë duhet të jenë të ndërgjegjshëm se perceptimet janë po aq të rëndësishme sa realiteti, dhe se ata duhet të tregojnë se janë duke punuar pa mbajtur anën e askujt gjatë gjithë kohës. Në rast se paanshmëria e një grupi vëzhguesish vendorë kompromentohet në çfarëdolloj faze, një gjë e tillë do të dëmtonte besueshmërinë e konstatimeve dhe të raporteve të tij.

Në rajonin e OSBE-së, grupet e vëzhguesve ndërkombëtarë pranë OSBE/ODIHR duhet të respektojnë një kod të sjelljes. Grupet e vëzhguesve vendorë nuk janë të detyruar ta zbatojnë këtë kod. Megjithatë, ata mund ta përdorin atë si bazë për të krijuar kodin e tyre të sjelljes. Në disa vende, autoritetit zgjedhor mund t'i kërkohet ligjërisht të hartojë një kod të sjelljes për vëzhguesit, por një gjë e tillë nuk duhet të prekë të drejtat e tyre bazë për të vëzhguar, dhe si rrjedhim, për të çuar përpara procesin zgjedhor.

Parime të tjera të vëzhgimit janë:

- ▶ Takimi me sa më shumë bashkëbisedues që të jetë e mundur, duke përfshirë një numër të madh partish politike. Vëzhguesit nuk duhet asnjëherë ta kufizojnë objektin e takimeve të tyre në partinë në pushtet ose tek opozita. Po ashtu, atje ku ekzistojnë komisionet zgjedhore me përfaqësues të të gjitha partive, vëzhguesit duhet të takohen me anëtarët e të gjitha rrymave politike;
- ▶ Nuk lejohet asnjëherë pjesëmarrja në një veprimtari të fushatës zgjedhore, por vetëm ndjekja e saj për qëllime vëzhgimi;
- ▶ Mosangazhimi në asnjë veprimtari që mund të krijojë një konflikt interesi. Kjo lidhet në mënyrë të veçantë në marrëdhëniet me biznesin, por mund të përfshijë edhe një veprimtari të mëparshme apo që është në zhvillim e sipër e që mund të krijojë konfuzion rolesh;
- ▶ Dallimi i qartë midis incidenteve të vëzhguara personalisht nga vëzhguesit dhe atyre të raportuara nga persona të tjerë;
- ▶ Raportimi duhet të jetë i ekuilibruar dhe të përfshijë zhvillimet pozitive dhe arritjet në proces, si dhe çdo parregullsi apo shkelje;
- ▶ Trajtimi i informacioneve delikate apo të dhëna në besueshmëri, veçanërisht kur bëhet fjalë për kërcënime apo ushtrim dhune;
- ▶ Dallimi i gabimeve që mund të jenë bërë nga zyrtarët e zgjedhjeve me shumë për shkak të mungesës së përvojës apo mosnjohjes së ligjit, se sa për shkak të ndonjë synimi të qëllimshëm për të kompromentuar integritetin e procesit.

G. AKREDITIMI

Vëzhguesve vendorë dhe ndërkombëtarë të zgjedhjeve u kërkohet zakonisht të kërkojnë akreditimin e tyre nga ana e administratës zgjedhore. Dhënia e akreditimit për një numër të madh vëzhguesish mund të jetë një punë shumë e madhe, ndaj është detyrim i çdo grupi vëzhguesish vendorë të sigurojnë që akreditimi të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara me ligj, apo me urdhëresat e administratës zgjedhore. Njësia e Administratës dhe Trainimit duhet të garantojë se dokumentacioni që kërkohet është plotësuar dhe i është dorëzuar autoriteteve në kohën e duhur duke lehtësuar kështu nxjerrjen e menjëhershme të dokumentave të akreditimit/identifikimit. Krijimi i një marrëdhënieje të mirë pune me autoritetet mund të lehtësojë procesin e akreditimit.

- Ë Siguroni dhe familjarizohuni plotësisht me gjithë legjislacionin që lidhet me zgjedhjet
- Ë Analizoni legjislacionin për të parë shkallën në të cilën ai garanton zgjedhje demokratike
- Identifikoni çdo mangësi në legjislacion për të përcaktuar me saktësi problemet potenciale gjatë zgjedhjeve dhe për rekomandimet pas-zgjedhore për ndryshim during an election and for post-election recommendations for change
- Krijoni një tabelë për konfliktet zgjedhore për të përcaktuar nëse mund të bëhet një rregullim ligjor dhe ndihmoni në kategorizimin dhe ndjekjen e çështjeve ligjore

A. RËNDËSIA E ANALIZËS LIGJORE

Një aspekt themelor në vëzhgimin e zgjedhjeve është analiza e kuadrit ligjor, për të parë shkallën në të cilën ai siguron mbajtjen e zgjedhjeve demokratike. Një analizë e kësaj natyre, e cila duhet të përfshijë kushtetutën dhe gjithë legjislacionin që lidhet me zgjedhjet, duhet të ndërmerret sa më shpejt që të jetë e mundur nga ekspertë ligjorë të Njësisë së Vëzhgimit, Koordinimit dhe Analizës. Ndërsa çështjet themelore duhen rregulluar nga legjislacioni bazë, është gjithashtu e pranueshme që edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të nxjerrë akte nënligjore që rregullojnë procedurat administrative. Pra edhe aktet nënligjore duhet të përfshihen në analizë.

Analiza e kuadrit ligjor mund të rezultojë në formulimin e rekomandimeve për të nxitur më tej përputhshmërinë me standartet dhe angazhimet ndërkombëtare, përfshi këtu standartet për të drejtat e njeriut, ose për ta bërë legjislacionin më koherent dhe të efektshëm. Kur hartojmë rekomandimet, duhet treguar vemendje që formulimi i tyre të bëhet me kujdes. Duhet dhënë shpjegime të qarta se përse bëhen rekomandimet. Rekomandimet mund të përdoren për të mbështetur ndryshimin dhe përmirësimin e legjislacionit zgjedhor para ose pas zgjedhjeve.

- ▶ A është e shprehur qartë formula zgjedhore për konvertimin e votave në mandate, dhe procedura për ndarjen e mandateve kandidatëve të veçantë?
- ▶ A trajton sistemi zgjedhor grupet e pakicave në mënyrë të drejtë dhe jo diskriminuese?

E Drejta për të Zgjedhur

Kuadri ligjor duhet të sigurojë që të gjithë qytetarëve në moshë madhore u garantohet e drejta universale dhe e barabartë për të votuar.

- ▶ A u është garantuar të gjithë qytetarëve në moshë madhore e drejta universale dhe e barabartë për të votuar?
- ▶ A siguron kuadri ligjor ushtrimin pa dallim të të drejtës për votim mbi bazën e trajtimit të barabartë përpara ligjit?
- ▶ A ka ndonjë kufizim apo pengesë lidhur me të drejtën për të votuar dhe në rast se po, a janë ato të justifikuara qartë nga rrethana të jashtzakonshme?

Komisionet e Zgjedhjeve / Autoritetet Zgjedhore

Kuadri ligjor duhet të kërkojë që komisionet e zgjedhjeve/autoritetet zgjedhore të krijohen dhe të funksionojnë në mënyrë të tillë që të sigurojnë administrimin e pavarur dhe të paanshëm të zgjedhjeve.

- ▶ A kërkon kuadri ligjor që komisionet e zgjedhjeve të caktohen në mënyrë të pavarur dhe të paanshme?
- ▶ A kërkon kuadri ligjor që komisionet e zgjedhjeve të funksionojnë në mënyrë të pavarur dhe të paanshme?
- ▶ A kërkon kuadri ligjor transparencë në krijimin dhe funksionimin e komisioneve të zgjedhjeve dhe a parashikon ai që vëzhguesit të monitorojnë punën e këtyre komisioneve?
- ▶ A përcakton qartë kuadri ligjor autoritetin dhe përgjegjësinë e secilit komision zgjedhjesh dhe marrëdhëniet e tij me organe të tjera qeveritare dhe autoritete ekzekutive?
- ▶ A parashikon kuadri ligjor mundësi të mjaftueshme për të kërkuar anulimin e një vendimi të një komisioni zgjedhor?
- ▶ A i mbron kuadri ligjor anëtarët e komisionit nga heqja arbitrare e tyre?

Trajtim dhe akses i barabartë në organet e shtypit

Kuadri ligjor duhet të sigurojë që të gjitha partitë politike dhe kandidatët të kenë mundësi për akses dhe trajtim të barabartë e pa dallim në median e zotëruar apo kontrolluar nga shteti. Nuk duhet të ketë kufizime të paarsyeshme ndaj të drejtës së partive politike dhe kandidatëve për të shprehur pikpamjet dhe mendimet e tyre lirisht gjatë fushatave zgjedhore.

- ▶ A u siguron kuadri ligjor partive politike dhe kandidatëve akses në media dhe trajtim të barabartë në mediat që zotërohen apo kontrollohen nga shteti?
- ▶ A siguron kuadri ligjor një formulë për akses dhe trajtim të barabartë, të tillë që të jetë e drejtë, e kuptueshme, dhe që mund të zbatohet në mënyrë objektive?
- ▶ A u siguron kuadri ligjor qytetarëve, kandidatëve dhe mbështetësve të tyre mundësinë për shprehje të lirë të pikpamjeve dhe mendimeve të tyre gjatë fushatave zgjedhore?

Financimi dhe shpenzimet për fushatën

Kuadri ligjor duhet t'u sigurojë të gjitha partive politike dhe kandidatëve trajtim të barabartë përpara ligjit, përsa i përket financimit dhe shpenzimeve për fushatën zgjedhore.

- ▶ A i siguron kuadri ligjor të gjitha partive politike dhe kandidatëve trajtim të barabartë përpara ligjit përsa i përket financimit dhe shpenzimeve për fushatën?
- ▶ Në rast se kuadri ligjor parashikon financimin publik apo përdorimin e burimeve shtetërore për fushatat, a parashikon ai trajtim të barabartë përpara ligjit për të gjitha partitë politike dhe kandidatët në lidhje me përdorimin e këtij financimi?
- ▶ A janë kufizimet për financimin privat të fushatave të arsyeshëm, të qarta dhe të zbatueshme në mënyrë objektive?
- ▶ A kërkon kuadri ligjor raportim periodik mbi kontributet dhe shpenzimet për fushatën?
- ▶ A parashikon kuadri ligjor të drejtën e publikut për t'u njohur me raportet në lidhje me kontributet dhe shpenzimet për fushatën?

metoda të tilla alternative kërkesat për fshehtësinë e votës me garancitë për sigurimin e votës?

- ▶ A e pengon kuadri ligjor një person të përdorë një metodë alternative votimi dhe procesin e rregullt të votimit në të njëjtat zgjedhje?

Transparenca në numërimin votave dhe nxjerrjen e rezultateve

Kuadri ligjor duhet të sigurojë që të gjitha votat numërohen dhe shënohen në tabela në mënyrë të saktë, të ndershme dhe transparente.

- ▶ A u siguron kuadri ligjor vëzhguesve mjete të arsyeshme për të vëzhguar numërimin e votave dhe nxjerrjen e rezultateve të votimit?
- ▶ A parashikon kuadri ligjor inspektimin e pavarur të të gjitha pajisjeve mekanike dhe elektronike, programeve kompjuterike dhe elementëve të tjerë në proceset e numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve atje ku përdoren metoda të tjera nga numërimi me dorë?
- ▶ A lejon ligji që të gjitha tabelat e rezultateve të jenë në një format të tillë që të mund të lejojë vëzhguesit të ndjekin rezultatet e çdo qendre votimi në të gjitha nivelet e grumbullimit të rezultateve përfundimtare?
- ▶ A lejon ligji që tabelat e rezultateve të përmbajnë informacion të hollësishëm mbi rezultatet e të gjitha metodave të votimit, si votimi lëvizës dhe votimi me postë?
- ▶ A kërkon ligji afishimin e menjëhershëm publik dhe botimin në mediane dhe shkruar të rezultateve të hollësishme që nga niveli i qendrës së votimit e deri në nivelin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve?
- ▶ A përcakton qartë ligji proceset për nxjerrjen përfundimtare të rezultateve të zgjedhjeve, njoftimin e kandidatëve, dhe mandatet për kandidatët e zgjedhur?
- ▶ A janë shprehur qartë të gjitha kërkesat dhe procedurat për një rinumërim të votave?
- ▶ A janë shprehur qartë të gjitha kërkesat dhe procedurat për zgjedhje të reja?

Menjëherë pas përfundimit, kjo analizë duhet të përshtatet në një tabelë kronologjike që korrespondon me afatet zgjedhore. Ky proces mund të përcaktojë mungesat, dublimet dhe dispozitat konfliktuale në ligje dhe mund të jetë i dobishëm në formulimin e rekomandimeve për përmirësimin e kuadrit ligjor.

Një pjesë nga një tabelë tip jepet më poshtë. Në këtë rast, në qoftëse një ankimues kërkon korrigjimin e një pasaktësie në listën e zgjedhësve dhe preferon ta kundërshtojë këtë pasaktësi duke iu referuar Kapitullit 30 të Kodit të Procedurës Civile, atëherë ai ose ajo do të konstatojë se nuk ka ndonjë obligim për të korrigjuar pasaktësinë edhe kur ajo provohet. Në rast se ankimuesi e trajton pasaktësinë duke iu referuar Nenit 20 të Ligjit për Zgjedhjet Presidenciale, atëherë ankimuesi është në gjendje të sigurojë një zgjidhje që kërkon korrigjimin e parregullsisë. Megjithatë, Neni 20 i Ligjit për Zgjedhjet Presidenciale kërkon që kërkesat ankimore të bëhen brenda tri ditësh që nga afishimi i listës paraprake zgjedhore, ndërsa Kapitulli 30 i Kodit të Procedurës Civile parashikon një kohë shtesë për paraqitjen e ankesave. Rrjedhimisht, përgatitja e tabelës ka identifikuar dispozita konfliktuale në lidhje me kohën e paraqitjes së një ankese. Ajo ka evidentuar gjithashtu se ka një hendek në Kapitullin 30 të Kodit të Procedurës Civile, që lidhet me faktin se ai nuk përmban ndonjë dispozitë që detyron kryerjen e korrigjimit.

Mënyra dhe Vendi ku paraqitet Ankesa	Afati për Ankesat	Afati për Marrjen në shqyrtim të Ankesës	Apelimi	Dispozita për Zbatim dhe Dënimi
Me shkrim pranë KQV	Brenda tri ditëve nga afishimi i listave paraprake të zgjedhësve	Tre ditë ose menjëherë në rast se ndodh një ditë para zgjedhjeve ose në ditën e zgjedhjeve	Gjykata e Rrethit	Detyrimi për të korrigjuar dhe gjobitur rëndë një anëtar të KQV në rast se moskorrigjimi nuk justifikohet qartë
Gjykata e Rrethit sipas rregullave zyrtare për ankimet në gjykatë	Jo më vonë se pesë ditë para zgjedhjeve	Tre ditë që nga dita e paraqitjes së ankesës	Një gjykatë e nivelit më të lartë	Asnjë

- Identifikoni tipet dhe kategoritë e ankesave, si dhe organin përgjegjës për trajtimin e fazave të ndryshme të ankimeve dhe apelimeve;
- Ndiqni çdo mosmarrëveshje gjatë fazave të ndryshme të ankimeve dhe apelimeve;
- Vlerësoni nivelin në të cilin sistemi i ankimeve dhe apelimeve është në gjendje t'u ofrojë zgjidhjen e përshtatshme ligjore personave të interesuar;

Gjatë zgjedhjeve, mund të lindin konflikte ku përfshihen kandidatë, parti, qytetarë, autoritete zgjedhore, organe të shtypit dhe institucione shtetërore. Mbështetja tek mekanizmat ligjorë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mund të jetë tregues për rritjen e besimit në zbatimin e ligjit dhe efektshmërinë e procesit ligjor. Dështimi apo vonesa në zgjidhjen e konflikteve mund të tregojë pamundësinë e sistemit për t'u dhënë zgjidhje ankesave të ligjshme.¹¹

A. MONITORIMI I ZGJIDHJES SË KONFLIKTEVE

Ekspertë ligjorë në Njësinë e Vëzhgimit dhe të Analizës duhet të përpiqen të klasifikojnë dhe të ndjekin çdo konflikt. Në rast se priten vetëm pak mosmarrëveshje, klasifikimi i secilës mosmarrëveshje mund të bëhet me kujdes dhe në mënyrë manuale. Në rast se pritet një numër i madh, atëherë hollësitë e mosmarrëveshjeve duhet të regjistrohen në një pro-

¹¹ Për informacion të mëtejshëm rreth mosmarrëveshjeve zgjedhore, shih *Resolving Election Disputes in the OSCE Area: Towards a Standard Election Disputes Monitoring System*, OSBE/ODIHR, Varshavë, 2001. Ky dokument mund të gjendet në faqen e internetit të OSBE/ODIHR në adresën <http://www.osce.org/odihr>.

Për secilin rast duhet të caktohet një numër unik identifikimi. Informacioni i ri duhet të regjistrohet ndërkohe që procesi i ankimit të çështjes është në vazhdimësi. Për shembull, një formular i ri duhet të plotësohet kur kanë përfunduar hetimet fillestare dhe autoriteti gjykues apo autoriteti i prokurorisë vendos që të fillojë procedurë ligjore zyrtare në lidhje me një ankesë. Numri identifikues i këtij rasti duhet të deklarohet gjithmonë në mënyrë që vëzhguesit të mund të ndjekin procedurat ligjore që kryhen për një ankesë.

Vëzhguesit duhet të përpiqen të jenë të pranishëm në gjykata apo komisione zgjedhore kur merret në shqyrtim një ankesë, veçanërisht për rastet me interes të madh publik. Një vëzhgues që ndjek shqyrtimin e një ankesë në gjykatë apo në komisionin e zgjedhjeve gjatë monitorimit të tij duhet të jetë rigorozisht i paanshëm dhe të respektojë një numër instruksionesh bazë:

- ▶ Të arrijë në kohë dhe të mos prishë në asnjë mënyrë qetësinë gjatë zhvillimit të seancave
- ▶ Të tregojë kujdes kur raporton apo komenton për rastet që janë në shqyrtim e sipër, pasi këto raste mund të jenë të tilla që nuk *duhet të publikohen paraprakisht*; dhe
- ▶ Të mos japë dëshmi gjatë shqyrtimit të rastit.

Kur vëzhgojnë një seancë për shqyrtimin e një ankesë në gjykatë apo në komisionin e zgjedhjeve, vëzhguesit duhet të shënojnë informacionin e mëposhtëm:

- ▶ Nëse ankimesi është në gjendje të sjellë para gjykatës apo komisionit të zgjedhjeve prova në mbështetje të ankesës, duke paraqitur dokumenta me shkrim, ose me dëshmi gojore;
- ▶ Nëse palët e tjera të interesuara janë në gjendje të paraqesin prova;
- ▶ Nëse seanca zhvillohet në publik; është e hapur për të gjithë personat e interesuar, përfshi median dhe publikun e gjerë; dhe nëse ndonjë pjesë e seancës zhvillohet më dyer të mbyllura e ku vëzhgimi është i pamundur;
- ▶ Nëse autoriteti gjykues tregon se po i trajton të gjithë me drejtësi, përfshi ankimesin, dëshmitarët dhe palët e interesuara;
- ▶ Nëse autoriteti gjykues duket se është i paanshëm në të gjitha aspektet;
- ▶ Nëse vendimi i autoritetit gjykues është në përputhje me vendime të tjera për raste të ngjashme; dhe
- ▶ Vëzhgime të tjera, veçanërisht komentet e autoritetit gjykues, që mbështesin të gjitha konkluzionet e arritura nga monitoruesi rreth seancës në fjalë.

- » Krijimi i komisioneve të zgjedhjeve;
- » Regjistrimi i partive/kandidatëve;
- » Regjistrimi i zgjedhësve;
- » Fushatë e paligjshme (nga partitë);
- » Fushatë e paligjshme (nga institucionet shtetërore);
- » Mbulimi nga media e subjekteve zgjedhore;
- » Kërcënimi i organeve të shtypit/gazetarëve;
- » Pengimi i bërjes së fushatës (nga ana e partive);
- » Pengimi i bërjes së fushatës (nga ana e institucioneve shtetërore);
- » Shkelja e të drejtave të votës në ditën e zgjedhjeve;
- » Shkelje e sigurimit të votave;
- » Shkelje gjatë numërimit;
- » Shkelje gjatë grumbullimit/nxjerrjes së rezultateve;
- » Saktësia e rezultateve përfundimtare, siç deklarohet.

Krijimi i një baze të dhënash me këtë lloj informacioni do të mundësonte përcaktimin e numrit të konflikteve sipas kategorive të ndryshme dhe se si janë zgjidhur ato. Më poshtë vijon një shembull se si mund të paraqiten këto të dhëna. Në këtë shembull jepen tabelat që duhen plotësuar për çdo kategori ankesash dhe se si shënohet një ankesë në një kategori të caktuar. Shqyrtimi i të gjitha ankesave në të gjitha tabelat do të tregojë se cila veprimtari zgjedhore ka gjeneruar shumicën e ankesave, ku janë vënë re shkeljet më të shumta, dhe nëse sistemi i ka zgjidhur ankesat në mënyrë të kënaqshme. Ky informacion do të jetë jashtëzakonisht i dobishëm për të vlerësuar nëse sistemi në fjalë u ka ofruar personave të interesuar një zgjidhje të përshtatshme ligjore. Ai mund të nxjerrë gjithashtu në pah problemet që lidhen me vendim-marrjen brënda administratës zgjedhore.

SAMPLE TABLE ON COMPLAINTS

NR.	DATA	KUJT I DREJTOHET	ANKIMUESI	ZONA QE PREKET	PERMBLED HJE E SANKESES	NDJEKJA E ÇESHTJES
T1/KZ-1	15.8.03	Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në	Partia për Një Qeveri të Mirë	100	<p><u>Pretendimi faktik:</u> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka caktuar një anëtar të Komisionit të Zonës Zgjedhore 100 i cili nuk është banor i Zonës 100, siç përcaktohet në Nenin 15 të Ligjit për Zgjedhjet.</p> <p><u>Baza Ligjore e Ankesës:</u> Neni 15 i Ligjit për Zgjedhjet kërkon që anëtarit i Komisionit të Zonës Zgjedhore të jetë banues i Zonës për të qenë anëtar komisioni.</p> <p><u>Zgjidhja që kërkohet:</u> Partia për Një Qeveri të Mirë kërkon largimin e anëtarit John Smith nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe caktimin e një personi që i plotëson kërkesat ligjore për antarësim, përfshirë edhe banimin.</p>	<p>Në dt.17.08.03 vëzhguesi Jan Doe mori pjesë në një mbledhje të KQZ-së ku u diskutua kjo ankesë dhe disa të tjera.KQZ-ja udhëzoi Sekretarin e saj të dërgonte me faks një letër në KZZ nr.100 ku i kërkonte të dhëna për vendbanimin e Xhon Smith brenda tri ditëve, përndryshe ai do të hiqej nga ajo KZZ.</p> <p>Më 21.08.03 vëzhguesi Robert Jones mori pjesë në një mbledhje të KQZ-së ku u diskutua kjo ankesë. KQZ-ja dispononte një kopje të noterizuar të një Vërtetimi Vendbanimi lëshuar nga Bashkia e West Town e vënë në dispozicion nga KZZ-ja 100, i cili vërtetonte se vendbanimi i Xhon Smith ndodhej në zonën 100. KQZ-ja e hodhi poshtë kërkesën e Partisë për Qeveri të Mirë.</p>

- Vlerësoni cilësinë e procesit të regjistrimit të zgjedhësve
- Po të jetë nevoja, kontrolloni saktësinë e listave të zgjedhësve, fillimisht duke përdorur sondazhet
- Vlerësoni ndikimin në zhvillimin e zgjedhjeve, të ndonjë mangësie në listat e zgjedhësve
- Vlerësoni nëse rrethet zgjedhore janë përcaktuar në mënyrë transparente për të siguruar, sa më shumë që të jetë e mundur se të gjitha votat kanë të njëjtën peshë

A. RËNDËSIA E REGJISTRIMIT TË ZGJEDHËSVE¹²

Regjistrimi i zgjedhësve është jashtëzakonisht i rëndësishëm për interesin publik për vendosjen e një qeverie të bazuar në vullnetin e popullit dhe është po aq i rëndësishëm për ata që kërkojnë të sigurojnë poste publike. Ai është një element kyç për të kontrolluar e gjetur individët që nuk plotësojnë për të marrë pjesë në një proces zgjedhor dhe për të identifikuar dhe regjistruar individët që i plotësojnë kërkesat dhe mund të gëzojnë të drejtën e votës. Me pak fjalë, regjistrimi i zgjedhësve është shumë i rëndësishëm për integritetin e zgjedhjeve.

Regjistrimi i zgjedhësve mund të kryhet në mënyra të ndryshme. Ai mund të jetë periodik (p.sh. para çdo zgjedhjeje), ose mund të jetë i rregullt (p.sh. i përditësuar një herë në vit e madje edhe çdo muaj). Ai mund të bëhet me iniciativën e individit (njerëzit duhet të shkojnë në qendrat e regjistrimit), me iniciativën e shtetit (zyrtarët shkojnë derë më derë), ose automatik/i krijuar nga shteti (emrat merren nga një regjistër identifikimi civil/kombëtar). Megjithatë një regjistër i krijuar nga shteti/automatik mund të mos kërkojë nga shteti apo individit një regjistrim aktiv, në mënyrë të rregullt apo periodike, të gjithë zgjedhësit e ligjshëm duhet të kenë të drejtë të kontrollojnë regjistrin dhe të gëzojnë të drejtën ligjore për të kundërshtuar dhe korrigjuar regjistrimin e emrit të tyre në të. Regjistrimi i zgjedhësve mund të jetë gjithashtu i detyrueshëm ose vullnetar.

¹² Ky kapitull mbështetet në një botim të Institutit Demokratik Kombëtar për Çështje Ndërkombëtare (NDI), me titull *Building Confidence in the Voter Registration Process*, botuar në 2001. Për më shumë informacion rreth vlerësimit të regjistrimit të zgjedhësve, grupet e vëzhguesve vendorë duhet të konsultojnë këtë dokument, i cili përfshin një përshkrim të hollësishëm se si të bëhet rishikimi i listave të zgjedhësve.

- ▶ Nëse procedura që përcakton se kush ka të drejtën sipas ligjit për të votuar, është e arësyeshme dhe zhvillohet si duhet;
- ▶ Nëse listat e zgjedhësve përmbajnë vetëm emrat e njerëzve të cilët plotësojnë kërkesat ligjore për të votuar dhe se ky informacion është i freskët dhe i saktë;
- ▶ Nëse publiku, partitë politike dhe organizatat qytetare kanë mundësinë e mjaftueshme për të kontrolluar listat e zgjedhësve për gabime apo mungesë emrash;
- ▶ Nëse publikut, partive politike dhe organizatave qytetare u është krijuar mundësia e mjaftueshme për të paraqitur pretendimet dhe kundërshtimet e tyre për emrat që duhen shtuar, hequr, apo korrigjuar në listat e zgjedhësve;
- ▶ Nëse pretendimet dhe kundërshtimet janë përpunuar sipas rregullit dhe nëse ndryshimet e duhura janë bërë në listat e zgjedhësve;
- ▶ Nëse partive politike dhe organizatave qytetare u janë dhënë kopjet e listave paraprake, listave të rishikuara si dhe kopjet e listave përfundimtare të zgjedhësve; dhe
- ▶ Nëse lista e zgjedhësve e përdorur në qendrën zgjedhore është e njëjtë me listën përfundimtare të zgjedhësve dhe nëse zyrtarët e përdorin atë rregullisht për të lejuar votimin e njerëzve.

Në rast se grupi i vëzhguesve vendorë tregon vëmendje serioze në lidhje me saktësinë e listave të zgjedhësve, atëherë ai mund të vendosë të ndërmarrë një hetim të hollësishëm në përpjekje për të nxjerrë numrin e pasaktësive të dyshuara. Meqenëse një hetim i tillë kërkon kohë dhe ekspertizë të konsiderueshme, grupi i vëzhguesve vendorë, para se të ndërmarrë një detyrë të tillë, duhet të jetë i sigurtë se ky është një problem që duhet trajtuar. Për të bërë këtë vlerësim, duhet pranuar se asnjë vend nuk ka lista zgjedhore 100 përqind të sakta.

C. ANALIZË KRAHASUESE E LISTAVE TË ZGJEDHËSVE DHE TË DHËNAT MBI POPULLSINË

Së pari kontrolli i saktësisë së listave të zgjedhësve mund të bëhet duke krahasuar madhësinë e përgjithshme të elektoratit me numrin korrespondues të qytetarëve në moshë për të votuar. Të dhënat për popullsinë duhet të sigurohen nga agjencia qeveritare që merret me statistikat kombëtare, e cila duhet të azhurnojë rregullisht të dhënat mbi numrin e popullsisë pas çdo regjistrimi të popullsisë. Krahasimi i numrit të personave mbi moshën 18 vjeç me madhësinë e elektoratit do të nxirrte në pah mjaft probleme të mundshme në lidhje me numrin e zgjedhësve në listat zgjedhore. Në rast se del se elektorati është shumë më i madh apo shumë më i vogël nga ç' duhet të jetë teorikisht, atëherë duhet të autorizohen kontrole të mëtejshme. Vëzhguesit duhet të kontrollojnë gjithashtu variacionet e të gjitha mangësive në nivel rajoni për të parë nëse problemet me listat shfaqen më shumë në disa bashkësi se sa në të tjerat.

përpjekur të regjistrohen, por që nuk figurojnë në lista. Ashtu si dhe me sondazhin për listat, edhe gjatë këtij sondazhi monitoruesit rajonalë angazhohen në intervistimin e rastësishëm të një numri të caktuar njerëzish, këte herë në shtëpi apo në rrugë, për të gjetur nëse emrat dhe adresat e tyre janë regjistruar sipas ligjit, dhe nëse ata kanë bërë përpjekje për t'u regjistruar. Përsëri monitoruesit rajonalë duhet ta shënojnë këtë informacion në pyetësorë dhe të përpiqen të kontrollojnë hollësisht e marra me listat e botuara për t'u siguruar nëse personat e intervistuar janë regjistruar sipas rregullit. Kjo metodë do të mundësojë një analizë të numrit dhe tipit të njerëzve të cilëve u është mohuar e drejta e tyre për të votuar, në veçanti nëse kjo ka prekur anëtarët e pakicave kombëtare.

Monitoruesit rajonalë që do të kryejnë njërin apo tjetrin sondazh duhet të jenë të trainuar mirë dhe të jenë të sjellshëm gjatë gjithë kohës. Ata duhet të jenë të hapur dhe transparentë rreth organizatës që përfaqësojnë dhe përse u nevojitet atyre informacioni që kërkojnë. Kujdes duhet treguar për t'u siguruar se njerëzit nuk kanë frikë nga sondazhi.

Asnjë nga tipet e sondazheve nuk mund të kryhet para se zyrtarët zgjedhorë të kenë nxjerrë listat paraprake të zgjedhësve. Sondazhet duhet të ndërmerren mjaft herët në procesin e përgjithshëm zgjedhor për të lejuar kështu kohë të mjaftueshme për kryerjen e veprimeve, në rast se identifikohen mangësi. Ka raste kur një grup vëzhguesish vendorë mund të sigurojë një kopje të listave paraprake të zgjedhësve nga autoritetet zgjedhore në nivel qendror. Një gjë e tillë mund të jetë e vështirë, sepse autoritetet zgjedhore mund të mos pranojnë t'i japin listat, ose këto lista mund të sigurohen vetëm në nivel lokal. Po të krijohet mundësia, një vëzhgues vendor duhet të përpiqet të sigurojë një kopje elektronike të listave të zgjedhësve për të lehtësuar zgjedhjen e rastësishme të emrave për sondazhin me listat.

E. KONTROLLET KOMPJUTERIKE

Kontrollet kompjuterike përfshijnë analizën e kopjes elektronike të listave të zgjedhësve për të parë gabimet dhe se si është punuar me to. Kontrollat të tilla bëhen nga autoritetet zgjedhore apo konsultuesit teknikë. Grupet e vëzhguesve zgjedhorë si dhe partitë politike duhet të kenë të drejtë të shqyrtojnë metodologjinë, zhvillimin dhe rezultatet e testeve të tilla kompjuterike dhe të bëjnë teste kompjuterike vetë.

Një kontroll kompjuterik konsiston në kërkimin e të gjitha të dhënave në listat e zgjedhësve për ata që i plotësojnë kriteret e caktuara. Një test i tillë mund të përcaktojë llojet e

F. MONITORIMI I FUSHATAVE PËR INFORMACION PUBLIK

Një grup vëzhguesish vendorë mund të dëshirojë të monitorojë fushatat e informative që zhvillohen nga autoritetet për të inkurajuar qytetarët të kontrollojnë regjistrimin e tyre në listat e zgjedhësve ose të regjistrohen. Një gjë e tillë është më e përshtatshme në rast se janë përhapur dyshime se emrat e një numri të madh zgjedhësish të ligjshëm nuk figurojnë fare në lista; se grupe të veçantë zgjedhësish, veçanërisht nga pakicat kombëtare, janë lënë jashtë listave; ose se ka shumë regjistrime të shumëfishta. Një grup vëzhguesish vendorë mund të vlerësojë nëse informacioni është dhënë në kohë, është i saktë, përjashton ndonjë grup qytetarësh të ligjshëm, dhe nëse është shpërndarë në mënyrë të tillë që krijon mundësi për një nivel të lartë pjesëmarrjeje. Kjo mund të bëhet:

- ▶ Duke përfshirë këtë çështje në veprimtaritë për monitorimin e medias (shih Kapitullin 9)
- ▶ Duke kontrolluar përmbajtjen, sasinë dhe shpërndarjen e informacionit të botuar nga autoritetet, në formë fletëpalosjesh dhe posterash; dhe
- ▶ Duke kontrolluar nëse informacioni i dhënë nga autoritetet është i disponueshëm në gjuhët e pakicave (në rast se shqetësimi lidhet me përjashtimin e pakicave nga listat).

Në rast se një grup vëzhguesish vendorë ka dyshime se zgjedhësit janë lënë jashtë listave ose, në qoftë se ai e vërteton këtë fakt nga një sondazh jashtë listave, ky grup mund të dëshirojë ta bëjë publik informacionin e tij për t'i inkurajuar qytetarët të regjistrohen dhe kontrollojnë emrat e tyre në listat e zgjedhësve. Në një rast të tillë, informacioni i dhënë duhet të jetë i saktë dhe me synimin për të arritur nivelin më të lartë të pjesëmarrjes së zgjedhësve. Grupi i vëzhguesve vendorë mund të dëshirojë të synojë grupe të veçantë zgjedhësish, si për shembull të rinjtë dhe zgjedhës nga pakicat kombëtare, të cilët mendohet se kanë më pak mundësi të jenë të regjistruar. Në rast se grupi i vëzhguesve vendorë angazhohet në një veprimtari të tillë, ai duhet të dijë se mund të jetë në shënjestër të akuzave për njëanshmëri nga partitë politike, dhe ai duhet të japë garanci se çdo informacion i dhënë është rigorozisht i paanshëm.

G. MONITORIMI I QENDRAVE TË REGJISTRIMIT TË ZGJEDHËSVE

Në qoftë se ligji lejon regjistrimin paraprak të qytetarëve në qendra të veçanta regjistrimi (ndryshe nga sistemet që bazohen në të dhënat e marra nga regjistrat e gjendjes civile ose në numërimin derë më derë), atëherë vëzhguesit mund të dëshirojnë të monitorojnë këto procedura regjistrimi. Metodologjia e përdorur duhet të jetë e ngjashme me atë të përdorur në vëzhgimin e procesit të votimit. Megjithatë, ndryshe nga procesi i votimit, regjistrimi i

asnjanëse, ndjekin me korrektësi procedurat përkatëse dhe u sigurojnë të dy palëve në konflikt kohën e duhur për t'iu drejtuar organit gjyqësor. Për këtë, një grup vëzhguesish vendorë mund të përdorin metodologjinë dhe mjetet e përdorura për monitorimin e mosmarreveshjeve të tjera (d.m.th me trajtim rast pas rasti), ose mund të kontrollojë një numër përfaqësues palësh në konflikt, për të vlerësuar nëse ligji është zbatuar në mënyrë të paanshme dhe me përpikmëri.


I. MONITORIMI I PËRCAKTIMIT TË KUFIJVE TË ZONAVE ZGJEDHORE

Sipas angazhimeve të OSBE-së, të gjitha votat duhet të kenë të njëjtën peshë për të siguruar një përfaqësim të barabartë. Kjo do të thotë se çdo përfaqësues i zgjedhur duhet të përfaqësojë një numër të njëjtë zgjedhësish të regjistruar. Për shembull, në një sistem zgjedhor maxhoritar, madhësia e elektoratit nuk duhet të ndryshojë me më shumë se afërsisht 10 për qind nga njëra zonë zgjedhore në tjetrën. Sipas sistemit proporcional të përfaqësimit, madhësia e elektoratit mund të ndryshojë, por numri i përfaqësuesve të secilës zonë duhet të jetë në përpjestim të drejtë me madhësinë e elektoratit. Ligji për zgjedhjet duhet të përmbajë kritere të hollësishme e uniforme për caktimin e kufinjve të zonave zgjedhore, duke specifikuar konsiderata të tilla si numri i popullsisë që voton për çdo zonë dhe vazhdimësinë gjeografike, administrative dhe historike të kufijve. Kufijtë duhen përcaktuar në mënyrë transparente, bazuar në parimin e asnjësisë politike dhe idealja do të ishte që ato të caktohen nga një komision ekspertësh pa parti. Grupi i vëzhguesve vendorë duhet të vlerësojë nëse zonat zgjedhore janë përcaktuar në mënyrë transparente për të siguruar sa më shumë që të jetë e mundur se të gjitha votat kanë të njëjtën peshë, ose nëse këto rrethe janë caktuar në një mënyrë përzgjedhëse, diskriminuese dhe të njëanëshme.

- Vlerësoni përbërjen, profesionalizmin dhe efektivitetin e administratës zgjedhore
- Vlerësoni nëse administrata zgjedhore ka qenë e paanashme dhe transparente në punën e saj
- Vendosni marrëdhënie të mira pune me komisionet e zgjedhjeve në të gjitha nivelet me qëllim që të jeni në gjendje të mbani takime të rregullta dhe të siguronit akses të informacionit përkatës

A. STRUKTURA E ADMINISTRATËS ZGJEDHORE

Organi përgjegjës për administratën e një procesi zgjedhor duhet të sigurojë besimin e konkuresve politikë dhe të publikut. Në shumicën e rasteve, zgjedhjet mbikqyren nga një komision kombëtar zgjedhës, i njohur shpesh me emrin Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që ka stafin e tij apo një sekretariat. Zakonisht ky komision është një organ i përherëshëm. Organet që punojnë nën KQZ janë komisionet më të ulëta të zgjedhjeve që zakonisht vendosen në rrethet administrative apo zgjedhore të vendit dhe komisionet e qendrave të votimit për çdo rreth zgjedhor. Përbërja dhe funksionet e secilit nivel të administratës zgjedhore duhet të përcaktohen qartë në ligj.



MODEL I HIERARKISË SË ADMINISTRATËS ZGJEDHORE

hjes, organizimit dhe tubimit pa dallim dhe në përputhje me atë çka parashikon ligji. Çdo trajtim i pjesshëm apo abuzim me autoritetin mund të paraqesë kërcënime serioze për legjitimitetin e zgjedhjeve.

→ **Transparenca:** Komisionet zgjedhore duhet të operojnë në mënyrë të hapur dhe transparente. Të gjitha aspektet e punës së tyre duhet të jenë të hapura për inspektim. Transparenca mund të arrihet në një numër mënyrash, përfshi përfaqësimin e partive në komisione, dhënien e aksesit për median dhe vëzhguesit, dhe botimin e menjëhershëm të vendimeve. Megjithatë, vëzhguesve jo gjithmonë u krijohet mundësia për të ndjekur drejt-përdrejt mbledhjet e komisionit.

→ **Rekrutimi dhe trainimi i stafit:** Të gjithë anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve duhet të marrin trajnimin e përshtatshëm e të standartizuar në një kohë të mjaftueshme para një procesi zgjedhor për t'i mundësuar ata të informohen plotësisht rreth kryerjes së detyrave të tyre. Sa më shumë të jetë e mundur, komisionet e zgjedhjeve duhet të kenë një numër përfaqësues grash dhe anëtarë të pakicave kombëtare.

→ **Burimet:** Administrata zgjedhore duhet të ketë një buxhet transparent, të mjaftueshëm dhe të pavarur. Ajo duhet të ketë gjithashtu kohë të mjaftueshme për të organizuar zgjedhje të besueshme dhe financat e materialet e nevojshme në kohën e duhur.

Tabela e mëposhtme thekson veprimtaritë kryesore që mund të jenë brenda autoritetit të niveleve të ndryshme të organeve të administratës zgjedhore.

Pyetjet kryesore që duhet të kenë parasysh grupet e vëzhguesve vendorë përfshijnë:

- ▶ A i trajtojnë komisionet zgjedhore të gjithë pjesëmarrësit në mënyrë të barabartë dhe të paanshme?
- ▶ A ka ndonjë vendim të marrë nga një komision zgjedhjesh, që ngre dyshime në lidhje me ruajtjen e paanshësisë?
- ▶ A munden komisionet e zgjedhjeve të veprojnë lirisht pa ndërhyrjet e paautorizuara apo të paligjshme nga ana e autoriteteve shtetërore dhe partive politike?
- ▶ A janë përgatitjet e komisioneve të zgjedhjeve të mjaftueshme për të siguruar një proces të ndershëm?
- ▶ A janë komisionet e zgjedhjeve transparente në vendim-marrjen e tyre?
- ▶ A respektojnë komisionet zgjedhore dispozitat ligjore?
- ▶ A janë komisionet e zgjedhjeve të hapura për apelime të drejta dhe të arsyeshme?
- ▶ A i respektojnë komisionet e zgjedhjeve afatet kohore sipas ligjit?
- ▶ A ka ndonjë komision zgjedhjesh që është kërcënuar apo i është bërë presion?
- ▶ A gëzojnë zakonisht komisionet e zgjedhjeve besimin e gjithë ndervepruesve?
Në rast se jo, a janë kritikata të justifikuara?
- ▶ A janë pakicat kombëtare dhe gratë të përfaqësuara sa duhet në komisionet e zgjedhjeve?

- Ndiqni nga afër regjistrimin e konkurentëve në zgjedhje për të vlerësuar nëse të gjithë kandidatëve dhe partive u janë dhënë mundësi të barabarta dhe të arësyeshme për të konkurruar në një zgjedhje
- Siguroni kopje të të gjithë dokumentacionit që lidhet me refuzimin e regjistrimit apo ankimit ndaj një refuzimi të tillë
- Vlerësoni nëse ndonjë grup i veçantë në shoqëri ka provuar diskriminim në procesin e regjistrimit

Paragrafi 7 i Dokumentit të Kopenhagenit garanton të drejtën qytetarëve për pretendimin e posteve politike, apo publike, si individë ose si përfaqësues të partive apo organizatave politike, pa dallim. Të gjitha forcat dhe lëvizjet politike duhet të lejohen të caktojnë kandidatët e tyre në kushte të barabarta dhe pa dallim. Çdo zbatim arbitrar apo diskriminues i ligjit që synon pengimin e forcave të caktuara politike bie ndesh me frymën e angazhimeve të OSBE-së për zgjedhjet demokratike.

A. REGJISTRIMI I PARTIVE POLITIKE

Legjislacioni zgjedhor duhet të përcaktojë se si dhe kur mund të kandidojnë partitë politike dhe kandidatët. Një ligj i veçantë (p.sh. një ligj mbi partitë politike) mund të përcaktojë se si një grup mund të regjistrohet si një parti. Çdo ligj që lidhet me regjistrimin e partive politike duhet, si rrjedhim, të analizohet dhe të përfshihet në tabelën e konflikteve zgjedhore (Shih Kapitullin 4). Një grup vëzhguesisht vendorë duhet të vlerësojë nëse aplikantët i plotësojnë kriteret për regjistrim dhe nëse rregullat janë respektuar me drejtësi dhe ndershmëri. Është shumë e rëndësishme që një grup vëzhguesisht vendorë të përcaktojë nëse procesi i plotëson standartet dhe angazhimet ndërkombëtare mbi lirinë e organizimit në shoqata.

regjistrimit të tyre tek autoritetet zgjedhore qendrore. Në këto kushte, monitoruesit rajonalë duhet të monitorojnë dhe raportojnë për regjistrimin e partive dhe kandidatëve. Ata duhet të informohen rreth proceseve të aplikimit dhe apelimeve dhe t'u sigurohet një mjet për t'i dërguar këto njoftime në zyrën qendrore.

Drejtimet kryesore të procedurave të vlerësimit për regjistrimin e kandidatëve dhe partive politike përfshijnë:

- ▶ Përpjekjen për të qenë të pranishëm gjatë verifikimit të kërkesave për kandidim të partive politike dhe kandidatëve;
- ▶ Përpjekjen për të rishikuar një numër kërkesash, të kontrolluara tashmë, për të parë nëse ato i janë nënshtruar të njejtit nivel vëzhgimi nga ana e autoriteteve zgjedhore;
- ▶ Përcaktoni nëse janë dhënë drejtimet kryesore apo udhëzimet zyrtare për verifikimin e firmave;
- ▶ Shikoni arësytimin për çdo refuzim kërkesë, verifikoni nëse arsyet për refuzim janë të bazuara dhe krahasoni kërkesat e refuzuara me ato të pranuar të një kandidati / partie tjetër;
- ▶ Përcaktoni nëse një komision zgjedhor ka votuar për ndonjë vendim për të pranuar apo refuzuar kandidatët/partitë. Kërkoni një kopje të procesverbaleve të ndonjë prej mbledhjeve ku ka ndodhur një gjë e tillë, për të parë se si kanë votuar anëtarët e komisionit;
- ▶ Përcaktoni se si dhe kur partitë politike dhe kandidatët e refuzuar janë njoftuar për vendimin dhe;
- ▶ Në rast se kërkesat janë refuzuar, shikoni nëse partia apo kandidati ka bërë ankesë ndaj këtij vendimi dhe në rast se po, ku janë ankuar ata dhe cili ka qenë rezultati i këtij apelimi.

C. REGJISTRIMI I GRAVE DHE I PAKICAVE KOMBETARE

Një grup vëzhguesish vendorë mund të dëshirojë të monitorojë faktin se sa gra dhe anëtare të pakicave kombëtare janë kandiduar nga partitë dhe janë regjistruar nga autoritetet zgjedhore. Shtete në rajonin e OSBE-së kanë konfirmur angazhimin e tyre për një numër standartesh ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, të cilat mbrojnë të drejtat e grave dhe pakicave kombëtare për të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të tyre (shih Kapitullin 1.) Duke monitoruar këtë proces, një grup vëzhguesish vendorë mund t'i paraqesë publikut informacion mbi numrin e grave dhe kandidatëve nga pakicat kombëtare që kanë kandiduar dhe janë regjistruar me sukses dhe një analizë të çdo lloj diskriminimi që është bërë.

- Bëni takime të rregullta me konkurentët për të parë nëse ata po hasin pengesa në lidhje me lirinë e tyre të shprehjes, organizimit dhe tubimit
- Ndiqni çdo ankesë me të gjithë zyrtarët që kanë lidhje me to
- Ndiqni e mingjet e fushatës dhe fjalimet në fushatë për të parë nëse ka ndonjë fjalim provokues
- Kontrolloni që burimet shtetërore të mos jenë përdorur në mënyrë të padrejtë në përfitim të partive në pushtet
- Monitoroni dhe vlerësoni çdo të fakt për kërcënim, shqetësim apo ndërhyrje në veprimtaritë e fushatave
- Ndërtoni një strukturë që të mundësojnë raportimin e monitorëve mbi të gjitha veprimtaritë e fushatës dhe veçanërisht për ndonjë incident të veçantë që ka shkaktuar shqetësim.

Liritë themelore janë esenciale për karakterin demokratik të fushatës zgjedhore dhe të gjithë pjesëmarrësit politikë duhet të gëzojnë të drejtën e organizimit dhe të jenë në gjendje t'i shprehin lirisht mesazhet e tyre në fushatë. Ata duhet të jenë të lirë të takohen me zgjedhësit në zonat e tyre zgjedhore pa iu nënshtruar kërcënimeve apo pengesave të ndryshme. Qytetarët duhet të kenë të drejtën të shprehin lirisht bindjet e tyre politike. Transparenca është gjithashtu një element i rëndësishëm që siguron se të gjithë pjesëmarrësit përfitojnë nga rregullat e fushatës, të cilat respektohen në mënyrë të barabartë dhe zbatohen në mënyrë të hapur dhe gjithëpërfshirëse. Shkalla se sa e drejtë është një periudhë zgjedhore për të qenë një fushë loje e barabartë për të gjithë pjesëmarrësit është shpesh një barometër i besueshëm për vlerësimin e procesit të zgjedhjeve në tërësi. Në minimumin e mundshëm, ai duhet të sigurojë që zgjedhësve t'u jepet informacioni bazë rreth gjithë konkurruesve në zgjedhje dhe në lidhje me thelbin e platformës së tyre politike.

Qëllimi i monitorimit para ditës së zgjedhjeve është të vlerësohet nëse ekziston një fushë loje e barabartë për të gjithë pjesëmarrësit dhe të përcaktohet nëse janë respektuar liritë e shprehjes, tubimit, organizimit, dhe të lëvizjes së qytetarëve. Normalisht, liri të tilla janë të sanksionuara në kushtetutën e një vendi dhe, gjatë një periudhe zgjedhore, mbrohen në mënyrë të veçantë nga legjislacioni zgjedhor. Këto të drejta janë përfshirë edhe në angazhimet e OSBE-së dhe në standartet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe duhen mbrojtur gjithmonë si me ligj ashtu dhe në praktikë.

duhet të kenë parasysh se partitë dhe mbështetësit e tyre mund të kenë një rend dite të tyren: të sigurojnë mbështetje dhe simpati për pozitat e tyre. Në një zgjedhje presidenciale, Njësia e Vëzhgimit, Koordinimit dhe Analizës duhet të takohet me të gjithë kandidatët kryesore. Në zgjedhjet parlamentare dhe vendore, monitoruesit rajonalë duhet të përpiqen të takojnë sa më shumë kandidatë nga i gjithë spektri politik.

B. TAKIMET ME MEDIAT

Anëtarët e Njësisë së Vëzhgimit, Koordinimit dhe Analizës duhet të lidhen me mediat në nivel kombëtar siç përshkruhet në Kapitullin 9. Monitoruesit rajonalë duhet të takohen me mediat në nivel vendor për të krijuar një panoramë të qartë për pronësinë e tyre, tendencën editoriale dhe audiencën, dhe për të marrë raportime për ndonjë shqetësim apo kufizim që ata kanë hasur. Takimet me mediat vendase do të krijonin gjithashtu mundësinë për të kontrolluar në detaje pretendimet e tjera dhe për të vlerësuar qëndrimin e gazetarëve dhe redaktorëve ndaj konkurruesve, administratës zgjedhore dhe organeve shtetërore gjatë procesit zgjedhor. Monitoruesit rajonalë duhet të shmangin çdo koment në media rreth procesit zgjedhor, me përjashtim të rasteve kur ata janë autorizuar në mënyrë të veçantë të kryejnë këtë veprim nga zyra qendrore.

C. TAKIMET ME ZYRTARËT PUBLIKË

Anëtarët e Njësisë së Vëzhgimit, Koordinimit dhe Analizës dhe monitoruesit rajonalë duhet të takohen me zyrtarët publikë për të marrë informacion të dobishëm për programin e vëzhgimit. Si në të gjitha takimet, vëzhguesit duhet të vendosin saktësisht para takimit se çfarë duan të pyesin dhe jo t'i humbasin kohën zyrtarit publik.

Gjatë periudhës së zgjedhjeve, ndodh që vëzhguesit të marrin ankesa dhe pretendime rreth veprimtarive të zyrtarëve publikë. Mund të ketë pretendime, për shembull, se një zyrtar ka penguar në mënyrë të paligjshme një kandidat apo parti në zhvillimin e fushatës së tij, ose se kanë përkrahur aktivisht një kandidat apo parti të caktuar. Pretendime të tilla është e vështirë të vertetohen, por janë serioze dhe duhet të hetohen me kujdes, pasi ato janë shkelje të angazhimeve ndërkombëtare mbi zgjedhjet, zakonisht janë shkelje të drejtës së brendshme dhe tregues të shpërdorimit të përgjegjësive.

Dëshmi zyrtare për sjelljen e zyrtarëve publikë mund të sillen gjithashtu nga një prokuror, nga policia, nga një gjykatë apo komision zgjedhor. Në situata të tilla, vëzhguesit duhet ta

sisht fjalët e përdorura nga folësi. Në qoftë se folësi ka nxitur dhunë, atëherë monitoruesit rajonalë duhet t'i raportojnë shqetësimet e tyre në selinë qendrore menjëherë.

Vëzhguesit duhet të raportojnë gjithashtu të gjitha rastet kur takimet, mitingjet apo ngjarje të tjera të fushatës nuk janë lejuar të zhvillohen. Në rast se autoritetet kanë refuzuar dhënien e lejes për ndonjë aktivitet, vëzhguesit duhet të kërkojnë shkaqet dhe të vlerësojnë nëse ato kanë qenë të arësyeshme.

E. MONITORIMI I SJELLJES SE FORCAVE TË SIGURIMIT

Gjatë fushatës dhe procesit të votimit, forcat e sigurimit kanë për detyrë të shmangin çdo kërcënim ndaj zgjedhësve dhe kandidatëve nga të tjerë njerëz dhe të veprojnë në mënyrë të paanshme. Kërcënimi mund të ketë një efekt të mbrapshtë si tek kandidatët edhe tek zgjedhësit, veçanërisht kur ky kjo gjë vjen nga forcat e sigurimit. Ndërkohë që është e vështirë të përcaktohet niveli i veprimeve kërcënuese, ka shumë mundësi që shfaqje të tilla kërcënuese, sidomos nga forcat e sigurimit, të jenë gjerësisht të pranishme.

Vëzhguesit duhet të shënojnë dhe vlerësojnë më kujdes çdo ndalim apo arrestim që mund të ketë lidhje me zgjedhjet. Ndalimet apo arrestimet e veprimtarëve politikë gjatë një periudhe zgjedhore janë ngjarje shumë serioze dhe mund të sinjalojnë se procesi zgjedhor nuk është në përputhje me standartet ndërkombëtare.

F. MONITORIMI I SHPENZIMEVE PËR FUSHATËN, I BURIMEVE DHE I SASISË SË DONACIONEVE

Çështjet që lidhen me financën dhe shpenzimet për fushatën janë një shqetësim në rritje brenda dhe jashtë rajonit të OSBE-së. Qytetarët duan të dinë se cili po i jep ndihmë financiare partive të tyre politike dhe kandidatëve të tyre, në çfarë mase ka qenë mbështetja dhe si shpenzohen këto fonde. Si rrjedhim, grupet e vëzhguesve vendorë po arrijnë gjithnjë e më shumë në përfundimin se është e nevojshme të kontrollohen shpenzimet dhe burimet e donacioneve për fushatën. Raportet e paraqitura mund të jenë nxitës për ndryshimin e ligjit në mënyrë që të rritet transparenca dhe përgjegjshmëria.

Monitorimi i çështjeve që lidhen me financat dhe shpenzimet për fushatën është i njohur si një proces i vështirë. Edhe kur legjislacioni i zgjedhjeve parashikon një institucion

përgjithshëm të shpenzimeve të një partie apo kandidati. Monitorimi i shpenzimeve për posterat dhe materialet për reklamën e partisë është më i vështirë, pasi i vetmi burim i arësyeshëm mbështetës është shtypshkronja që ka shtypur materialet - partive apo kandidatëve u duhet kërkuar ky informacion që në fillim. Meqënëse legjislacioni zgjedhor shpesh kërkon që materialiet e shtypura të përfshijnë emrin e partisë politike apo kandidatit dhe emrin e shtypshkronjës, një vëzhgues vendor mund të kërkojë t'i jepen hollësira për koston dhe sasinë e fletëve të shtypura.

Në rast se ky informacion nuk i jepet, atëherë e vetmja mundësi mbetet përpjekja për të numëruar posterat që janë afishuar dhe vlerësimi i koston në bazë të cilësisë së materialit të shtypur. Kjo kërkon kohë dhe nuk është shumë e saktë, por jep një ide rreth niveleve të shpenzimeve.

VËZHgues VENDORË RUMUNË KONTROLLOJNË FINANCAT PËR ZGJEDHJET

Në nëntor 1999, një anketë publike në Rumani zbuloi se kishte nivele alarmuese të mosbesimit publik në lidhje me burimet dhe përdorimin e fondeve të fushatës nga partitë politike. Në përpjekje për ta hapur çështjen për një inspektim dhe debat më të madh, një grup vëzhguesish vendorë i quajtur Shoqata Pro-Demokraci (PDA) ngriti një ekip ekspertësh për ta parë këtë çështje gjatë zgjedhjeve vendore të vitit 2000.

PDA inspektoi çdo parti politike dhe agjentët e tyre të reklamave për të marrë informacion rreth sasive dhe llojit të shpenzimeve dhe burimeve të donacioneve. Ata nxorën vlerën e kohës dhe hapësirës së blerë në burime të ndryshme të medias dhe llogaritën koston. Disa parti shfaqën më shumë dëshirë të bashkëpunonin me ekipin e PDA-së se sa disa të tjera, veçanërisht në lidhje me burimet e donacioneve. Nga informacioni i mbledhur, PDA arriti të identifikonte parregullsitë në lidhje me shpenzimet për fushatën. Duke përdorur raportin e botuar pas këtij verifikimi, PDA kërkoi me këmbëngulje ndryshimin e ligjit për financën e fushatës për të siguruar më shumë transparencë dhe përgjegjshmëri.

Përdorimi i programeve të patronazhit, punëve publike e programeve të ngjashme me to për avantazh elektorale është një aspekt tjetër që tregon për veprime të papërshtatshme nga ana e qeverisë. Ndërsa është e vështirë të identifikohen dhe të maten efektet e programeve të tilla, vlen të shihet nëse të mirat e këtyre programeve ofrohen më shumë në emër të një partie politike apo kandidati, se sa në emër të qeverisë. Është gjithashtu e mundur të provohet nëse projekte të tilla janë mbështetur apo kanë filluar vetëm pak përpara një periudhe zgjedhjesh.

Në disa vende, partitë qeverisëse dhe kandidatët, në nivel kombëtar apo më të ulët, janë vëzhguar të kenë keqpërdorur burimet publike në përfitim të tyre. Në rast se ka një kod etike apo udhëzime për etikën e ministrave dhe zyrtarëve qeveritarë, atëherë vëzhguesit duhet të monitorojnë respektimin e këtyre dokumentave. Në mungesë të një kodi të tillë, vëzhguesit duhet të trainohen me kujdes në lidhje me ligjshmërinë dhe përdorimin e burimeve shtetërore gjatë një periudhë zgjedhore.

Monitorimi i përdorimit të burimeve shtetërore kërkon një vëmendje të veçantë. Vëzhguesit duhet të shënojnë me kujdes e në mënyrë të hollësishme të gjitha rastet e verifikuara të keqpërdorimeve. Po ashtu mund të llogaritet edhe kostoja e burimeve të tilla të keqpërdorura.

Një çështje tjetër që duhet shqyrtuar është presioni ndaj punonjësve publikë apo ndaj personelit ushtarak për të votuar për një parti apo kandidat të caktuar – që zakonisht është i lidhur me autoritetet e këtyre strukturave. Ky veprim është vëzhguar në një numër vendesh dhe ngre dyshime në lidhje me abuzimin me të drejtat e njeriut. Pretendimet për fushatë të paligjshme në vendin e punës, presion dhe veprime kërcënuese, për lidhjen e përkatësisë politike me punësimin dhe “blerjen e votës” në shkëmbim të mallrave dhe shërbimeve falas (pavarësisht nëse janë siguruar apo jo nga fonde publike) duhen hetuar deri në fund.

H. PARANDALIMI I KONFLIKTEVE DHE MONITORIMI I DHUNËS ZGJEDHORE

Zgjedhjet duhet të lejojnë që palët konkurruese të kenë mundësinë të konkurrojnë për pushtet politik pa përdorur forcën. Megjithatë, për fat të keq, ka raste kur ka shfaqje dhune. Në të tilla raste, përgjegjësia për menaxhimin dhe zgjidhjen e konflikteve i takon autoriteteve përkatëse. Vëzhguesit vendorë duhet ta monitorojnë këtë me kujdes.

Metodologjia për monitorimin e dhunës që lidhet me zgjedhjet është e ngjashme me atë që përdoret në monitorimin e mosmarrëveshjeve zgjedhore. Monitoruesit rajonalë të Njësisë së Vëzhgimit, Koordinimit dhe Analizës që janë dëshmitarë të dhunës duhet të plotësojnë një “formular incidentesh të rënda”, i cili përcakton:

- ▶ Vendin e ngjarjes, përfshi zonën zgjedhore apo administrative;
- ▶ Viktimën (at);
- ▶ Shkaktari (ët) (në rast se dihen);
- ▶ Data kur ka ndodhur incidenti;
- ▶ Natyra e incidentit, përfshij raportet nga dëshmitarët dhe policia;
- ▶ Nëse incidenti po hetohet nga policia; dhe
- ▶ Klasifikimi i incidentit.

Vëzhguesit duhet të veprojnë në mënyrë të paanashme në grumbullimin e këtij informacioni dhe të intervistojnë një pjesë të madhe të dëshmitarëve, përfshi policinë, kur kjo është e mundur.

Klasifikimi i një incidenti ka shumë rëndësi për analizimin e natyrës dhe shpeshtësisë së dhunës që lidhet me zgjedhjet. Një mënyrë për ta bërë këtë është klasifikimi i incidenteve në të rënda dhe të vogla. Në incidentet e rënda do të përfshiheshin vrasjet, tentativat për vrasje, rrëmbimi, tentativa për rrëmbim, dëmtimi i rëndë fizik, trazirat, djegiet, grabitjet dhe sulmet. Incidentet e vogla do të përshinin kërcënimet, dëmtim prone dhe provokimin e trazirave.¹⁴ Vëzhguesit duhet të ndjekin çdo lloj incidenti të kësaj natyre për t'u siguruar nëse shkaktarët janë çuar para drejtësisë. Ata nuk duhet të ndërhyrjnë në ndonjë hetim zyrtar.

Mbizotërimi i dhunës në një proces zgjedhor mund të jetë faktor vendimtar për një grup vëzhguesish vendorë për të nxjerrë një deklaratë shumë negative rreth këtyre zgjedhjeve. Duke patur parasysh këtë, të gjitha incidentet duhet të dokumentohen qartë dhe të verifikohen. Përveç kësaj, kujdes duhet treguar në dallimin midis veprimtarive kriminale dhe veprimtarive të tjera të paligjshme që lidhen me to, dhe që janë rezultat i zgjedhjeve/përkrahjes politike dhe atyre që nuk janë të tilla.

¹⁴ Për më shumë informacion mbi këtë metodologji, lexuesit mund të vizitojnë faqen e internetit të Qendrës për Monitorimin e Dhunës në Zgjedhje (CMEV) në SRI Lanka në adresën <http://www.cpalanka.org>.

- Ë Zhvilloni një program për monitorimin e organeve të shtypit, që të përfshijë një vlerësim cilësor dhe sasior të mbulimit të shtypit, për të përcaktuar nëse konkurruesve u është siguruar akses i arsyeshëm dhe i drejtë në organet e shtypit gjatë periudhës së fushatës
- Ë Kushtojini vëmendje të veçantë vlerësimit të shkallës së mundësisë së organeve shtetërore të shtypit/apo publike për t'u siguruar konkurrentëve një mbulim të drejtë dhe të paanshëm
- Ë Monitoroni nëse organet e shtypit përballen me ndonjë kufizim apo veprime kërcënuese

A. RËNDËSIA E MONITORIMIT TË ORGANEVE TË SHTYPIT¹⁵

E drejta për lirinë e shprehjes është përfshirë në Nenin 19 të Deklaratës Universale të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Shtetet që bëjnë pjesë në rajonin e OSBE-së kanë riafirmuar në Paragrafin 9 të Dokumentit të Kopenhagenit se “cilido gëzon të drejtën e lirisë së shprehjes, përfshi dhe të drejtën e komunikimit.” Përveç kësaj, Paragrafi 7 kërkon që partitë politike dhe kandidatët nuk duhet të kenë pengesa në aksesin e tyre në mjetet e informacionit pa dallim. Asnjë demokraci nuk mund të zhvillohet në rast se qytetarët e saj nuk kanë informacionin që u nevojitet për të bërë zgjedhjet që u kërkohen gjatë seleksionimit të përfaqësuesve të tyre në qeveri. Po ashtu, mjetet e informacionit nuk mund të ecin përpara në rast se ka ndërhyrje pa vend nga shteti në transmetimet e tyre ose në rast se gazetarët censurohen apo frikësohen.

Në vendet me tradita të vjetra demokratike dhe me shtyp të lirë, janë shtuar mundësitë për mbrojtjen e lirisë së fjalës, shtypit dhe informacionit, që të gjitha së bashku e lehtësojnë mirëinformimin e qytetarëve. Po ashtu, në demokracitë e vendosura tashmë, gazetarët profesionistë shpesh kanë vetë-caktuar rregulla të sjelljes që shmangin njëanshmërinë. Në demokracitë më të reja, shumë nga këto tradita dhe standarte janë të zhvilluara më pak. Rrjedhimisht, për qytetarët e këtyre vendeve është më e rëndësishme të kërkojnë profesionalizëm dhe objektivitet nga mjetet e informacionit dhe monitorimin e mbulimit prej tyre të partive politike, kandidatëve, zyrtarëve qeveritare dhe të çështjeve publike.

¹⁵ Ky kapitull bazohet në materialin e dhënë në një botim të Institutit Kombëtar Demokratik për Çështjet Ndërkombëtare (NDI) me titull *Monitoring the Media in Transition Elections: An NDI step-by-step Handbook*, i shkruar nga Robert Norris dhe botuar në 2002. Për më shumë informacion rreth monitorimit të mjeteve të informacionit, grupet e vëzhguesve vendorë duhet ta konsultojnë këtë dokument, i cili përfshin një përshkrim të hollësishëm të mënyrës se si zbatohet një program për monitorimin e mjeteve të informacionit. Përveç kësaj, neni XIX ka gjithashtu dy udhëzues shumë të rëndësishëm për monitorimin dhe standartet e mjeteve të informacionit. *Guidelines for Election Broadcasting in Transitional Democracies, 1994* dhe *Election Reporting – a practical guide to media monitoring, 1998*. Informacioni rreth këtyre botimeve mund të gjendet në faqen e internetit per Nenin XIX në adresën <http://www.article19.org>.

portimit te ekuilibruar dhe të shmangin fjalimet me urrejtje dhe mjete të tjera që nxisin dhunën dhe urrejtjen; dhe

- ▶ Ë Të propagandojnë ndryshimet pozitive në rregullat dhe rregulloret për mjetet e informacionit në mënyrë që ato të jenë në përputhje me standartet ndërkombëtare.

C. VLERËSIMI I KUADRIT LIGJOR QE RREGULLON ORGANET E SHTYPIT

Para fillimit të monitorimit të mjeteve të informacionit, është e nevojshme të rishikohen ligjet dhe rregulloret që lidhen me të dhe që rregullojnë sjelljen e mjeteve të informacionit. Kjo duhet bërë nga monitoruesit që punojnë së bashku me këshilltarët ligjorë në Njësinë e Vëzhgimit, Koordinimit dhe Analizes. Rishikimi duhet të përfshijë dispozitat përkatëse kushtetuese, legjislacionin dhe rregullat përkatëse të nxjerra nga entet rregullatore. Do të ishte i dobishëm takimi me ndonjë prej enteve rregullatore të kësaj fushe, si p.sh. një autoritet për standartet e mjeteve të informacionit, autoritet licensimi për mjetet e informacionit, autoritet për licensimin e frekuencave, etc. Këto organe kanë një autoritet rregullues te konsiderueshëm në mjetet e informacionit dhe është e rëndësishme që funksionet dhe roli i tyre të kuptohen qartë. Mund të ishte gjithashtu me vlerë përfshirja e një përshkrimi të rolit të tyre në tabelën e konflikteve zgjedhore (shih Kapitullin 3 dhe 4) dhe regjistrimi i konflikteve që lidhen me mjetet e informacionit si një kategori më vete në tabelë.

D. MONITORIMI I OPERATORËVE RADIOTELEVIZIVË DHE I MEDIAS SË SHKRUAR

Monitorimi i mjeteve të informacionit duhet të fillojë të paktën një muaj para ditës së zgjedhjeve dhe të përfundojë menjëherë sapo të deklarohen rezultatet. Do të ishte ideale që ky monitorim të fillonte sa më shpejt që të ishte e mundur, e preferueshme do të ishte atëherë kur administrata zgjedhore fillon përgatitjet për zgjedhjet dhe të vazhdonte deri sa të zgjedhurit të merrnin postet e tyre. Përpjekjet për monitorim mund të vazhdonin edhe pas zgjedhjeve, për të siguruar një prani më të përhershme në shoqërinë civile që do të punonte kundër njëanshmërisë në të ardhmen në mjetet e informacionit dhe për të propaganduar liritë e mjeteve të informacionit.

kenë një ndikim tek elektorati. Mbulimi i këtyre temave dhe çështjeve mund të jetë i rëndësishëm në përcaktimin e nivelit të asnjësisë dhe vetë-censurimit. Përsëri, është e rëndësishme të shihet niveli i debatit politik ku pikpamjet e partive apo kandidatëve sfidohen drejtpërdrejt nga kundërshtarët e tyre politikë. Subjekte dhe tema që kanë lidhje me këto çështje (ato të shënuara me një yll duhet të seleksionohen në rast se kanë lidhje) përfshijnë:

- » Ë Presidentin;
- » Ë Zëdhënësin apo zyrën e presidentit;
- » Ë Qeverinë;
- » Ë Kryeministrin;
- » Ë Ministrat kryesorë të qeverisë (të gjithë ministrat në rast se ata kërkojnë të zgjidhen);
- » Ë Drejtuesit e partive politike;
- » Ë Partitë politike dhe kandidatët e nivelit të lartë;
- » Ë Drejtuesit rajonalë;*
- » Ë Kryetarët e zgjedhur të bashkive;*
- » Ë Drejtuesit e organeve ekzekutive vendore;*
- » Ë Partitë bojkotuese* (në rast se ka ndonjë);
- » Ë Fjalimet me terma provokuese dhe me urrejtje;*
- » Ë Pakicat kombëtare dhe mbulimi në gjuhët e pakicave*
- » Ë Periudha e “heshtjes zgjedhore”;*
- » Ë Kufizime mbi mbulimin e anketimeve nga publiku;*
- » Ë Reklama me pagesë për partinë dhe kandidatin;*
- » Ë Fushata të edukimit të votuesve;*
- » Ë Grupi i vëzhguesve vendorë.*

Monitoruesit e mjeteve të informacionit duhet të bëjnë kujdes të dallojnë midis “minutazhit falas”, shpesh të sanksionuar në legjislacion, dhe raportimeve të tjera. Në lidhje me këtë, monitoruesit duhet të vlerësojnë:

- » Ë Nëse janë respektuar dispozitat për minutazhin falas;
- » Ë Nëse “kushtet” e transmetimit ishin të barabarta për të gjitha subjektet (p.sh., koha e transmetimit);
- » Ë Nëse ato u transmetuan në një kohë dhe me një format që u jepte shikuesve mundësinë për t'i ndjekur; dhe
- » Ë Nëse transmetimet e minutazhit falas i kanë ndihmuar qytetarët të kuptojnë zgjedhjet në dispozicion të tyre.

- ▶ Ë Përdorimi i shprehjeve, komenteve, apo përshkrimeve që duket të jenë sarkastike, të pabazuara, jo-profesionale apo fyese;
- ▶ Përdorimi i qëllimshëm i këndeve të filmimit, p.sh. për t'i bërë pjesëmarrësit në mitingjet e partive apo kandidatëve të duken më të shumtë ose më të pakët në numër nga ç'janë në të vërtetë; dhe
- ▶ Ë Përdorimi i fotografive apo i efekteve zanore për të mbivlerësuar, nënvleftësuar apo për të vënë në lojë kundërshtarët politikë.

Në median e shkruar duhet bërë dallim midis editorialeve, shkrimeve që shprehin opinionin e gazetës dhe letrave nga njëra anë, dhe botimit të lajmeve nga ana tjetër. Analiza e të parës mund të hedhë dritë sa duhet rreth njëanshmërisë së gazetës (numri i editorialeve dhe letrave në favor të një partie apo kandidati të caktuar dhe që kundërshton të tjerët), ndërsa synimi i mbulimit me lajme të përgjithshme duhet përsëri t'i përmbahet parimit të paanshmërisë.

Mbulimi i veprimtarive të qeverisë gjatë një periudhe zgjedhore paraqet një problem të vështirë. Ndërsa burimet e informacionit u japin qytetarëve informacionin që lidhet me veprimtaritë e rëndësishme qeveritare, një mbulim i tillë natyrisht i jep partisë apo koalicionit qeverisës një avantazh të madh në përcjelljen e mesazhit tek zgjedhësit e tyre. Gjatë vlerësimit të mbulimit të qeverisë, duhet treguar kujdes për të bërë dallimin midis “njoftimeve për shërbimet publike” dhe “shpalljes së politikave publike” që përdoren nga kandidatët për të propaganduar rizgjedhjen e tyre. “Njoftimet për shërbimet publike” mund të jenë të nevojshëm për arësye krejtësisht të ligjshme të një qeverisjeje të mirë, p.sh. dhënia e statistikave zyrtare. Në të kundërt, “shpalljet e politikave publike” përdoren për të influencuar opinionin publik në favor të partisë apo koalicionit qeverisës gjatë një periudhe zgjedhore.

Të dhenat sasiore dhe cilësore duhet të hidhen në formularë monitorimi të përpiluara posaçërisht dhe të kalohen pastaj në programe kompjuterike ku ato mund të transformohen në prezantime të thjeshta grafike për t'u lexuar, siç janë histogramat me format linear apo rrethor. Të gjitha të dhënat e shënuara, shiritat e regjistruar dhe gazetat duhet të ruhen në arkiva për ndonjë kontroll në të ardhmen, në rast se rezultatet vihen në dyshim.

Në rast se kryhen sistematikisht dhe paraqitet me besueshmëri, analizat sasiore dhe cilësore, mund të japin një provë bindëse nëse burimet e informacionit po përpiqen të bëjnë një mbulim të ekuilibruar duke iu dhënë akses të gjitha subjekteve për të paraqitur pikpamjet e tyre. Një shembull i paraqitjeve grafike të nxjerra nga monitorimi sasior dhe cilësor i programeve informative jepet më poshtë. Ky shembull i veçantë tregon një mbulim shumë partiak të një kanali televiziv në favor të një kandidati që mban postin e presidentit.

E. MONITORIMI I REKLAMËS POLITIKE ME PAGESË DHE INFORMIMI I ZGJEDHËSVE

Monitorimi i reklamës së paguar politike mund të jetë i dobishëm por ai kërkon shumë kohë. Monitorimi i medias elektronike duhet të jetë i vazhdueshëm, pasi reklamat mund të transmetohen në çdo kohë të ditës (në rast se e lejon ligji). Analiza do të tregojë përmbajtjen e reklamave, cilët janë objektivat kryesore të sulmit, nëse janë përdorur fjalime më terma ngacmuese apo me urrejtje dhe cilat janë mesazhet kryesore të partive apo kandidatëve të ndryshëm. Kjo analizë do të japë gjithashtu një informacion të bazuar rreth sasisë së reklamës së blerë, nga e cila mund të bëhen vlerësime për sasinë e fondeve që janë shpenzuar (shih seksionin për monitorimin e financimit të fushatës).

Një grup vëzhguesish vendorë mund të vendosë të monitorojë fushatat për informimin e zgjedhësve dhe informimin publik në rast se mendon se njohja e procesit zgjedhor dhe/ose roli e funksioni i organit që do të zgjidhet është në një shkallë të ulët. Ai mund të arrijë gjithashtu në konkluzionin se bëhet fjalë për një gjë të rëndësishme në qoftë se konstatohen probleme me listat e zgjedhësve apo shqetësime në lidhje me nivelin e ulët të pjesëmarrjes. Monitorimi i fushatave për informimin e zgjedhësve dhe informimin publik do të jepte njohuri të dobishme rreth nivelit të informacionit për pakicat kombëtare, nëse ky informacion është dhënë në gjuhën e pakicave dhe nëse në të përfshihet ndonjë element njëanshmërie.

F. MONITORIMI I KËRCËNIMEVE NDAJ ORGANEVE TË SHTYPIT DHE GAZETARËVE

Një grup vëzhguesish vendorë duhet të vendosë kontakte dhe të takohet rregullisht me gazetarët dhe përfaqësuesit e organizatave të mjeteve të informacionit për të shpjeguar se si zhvillohet monitorimi i mjeteve të informacionit, për të kuptuar strukturën dhe pronësinë e mjeteve të informacionit në vend dhe për të parë nëse ka patur ndonjë presion apo provokim.

Format tipike të shqetësimeve, për të nxitur vete-censurimin, luhaten nga dhuna ose repressioni i drejtëpërdrejtë politik deri në forma më të tërthorta të ngacmimeve, si p.sh. inspektimeve të pajustificuara për taksat; mosmarrëveshje për licencat; dhe ndërprerja e furnizimeve për gazetatat dhe e shpërndarjes së tyre. Një grup vëzhguesish vendorë duhet të sigurojnë se çdo pretendim për shqetësime duhet të verifikohet dhe shënohet me saktësi. Secili rast duhet të dokumentohet dhe ndiqet me kujdes. Ka mundësi që pretendimet për shqetësime mund të rezultojnë në një kërkesë ankimore të ligjshme nga ana e organizatave të mjeteve të informacionit apo gazetarëve. Në këtë rast, ky konflikt duhet të ndiqet në të njëjtën mënyrë si dhe të gjitha mosmarrëveshjet e tjera zgjedhore (shih Kapitullin 4).

- Ë Vendosni për masën dhe natyrën e vëzhgimit që do të kryeni
- Ë Sigurohuni që vëzhguesit të jenë trainuar për procedurat e zgjedhjeve, formatet e raportimit dhe kodin e sjelljes
- Ë Sigurohuni nëse vëzhguesve u është dhënë mbështetja e plotë logjistike dhe metodologjike në të gjitha nivelet
- Ë Vendosni një strukturë koherente raportimi
- Ë Sigurohuni për kthimin dhe analizën në kohë të protokolleve

Pothuajse çdo grup vëzhguesish vendorë është përpjekur të vëzhgojë votimin dhe numërimin e votave, shpesh me një sukses të madh. Megjithatë, mobilizimi i mijra vëzhguesve vullnetarë në qendrat e votimit mund të tërheqë një numër shumë të madh burimesh njerëzore si në nivel kombëtar ashtu dhe në atë rajonal, herë herë në dëm të veprimtarive të tjera vëzhguese. Prandaj është themelore që një grup vëzhguesish vendorë ta ketë të qartë se çfarë duhet vëzhguar në ditën e zgjedhjeve dhe se sa mirë duhet bërë ky vëzhgim.

Pyetjeve të mëposhtme u duhet dhënë përgjigje sa më shpejt të jetë e mundur, mundësisht që gjatë vlerësimit të nevojave:

- ▶▶ Ë A duhet të vendosen vëzhgues në çdo qendër votimi apo në një numër qendrash të zgjedhura rastësisht?
- ▶▶ Ë A duhet të jenë vëzhguesit “statikë”, pra të vëzhgojnë votimin dhe numërimin në një qendër votimi gjatë gjithë ditës?
- ▶▶ Ë A duhet të jenë vëzhguesit “të lëvizshëm”, pra të vëzhgojnë votimin në një numër qendrash votimi?
- ▶▶ Ë A duhen vendosur vëzhgues statikë në të gjitha qendrat e votimit, që gjenden në të ashtuquajturat “pika të nxehta”?
- ▶▶ Ë A duhet të synohet vëzhgimi dhe regjistrimi i rezultateve në secilën qendër votimi?
- ▶▶ Ë A duhet të synohet vëzhgimi dhe regjistrimi i rezultateve në një numër qendrash votimi të caktuara rastësisht?

Vëzhguesit duhet të jenë të sjellshëm gjatë gjithë kohës ndërsa kryejnë detyrat e tyre dhe të kujtojnë se ata përfaqësojnë grupin e vëzhguesve vendorë të ngarkuar me organizimin e programit të vëzhgimit. Kur hyjnë në një qendër votimi, ata duhet të prezantojnë veten tek kryetari/drejtuasi i qendrës dhe tek zyrtarët e tjerë të qendrës së votimit. Përveç bisedës me zyrtarët e qendrës së votimit, vëzhguesit duhet të përpiqen të bisedojnë me secilin vëzhgues të pranishëm që përfaqëson partitë apo kandidatët; apo me vëzhguesit e huaj, në qoftë se ka të pranishëm; dhe me vetë zgjedhësit për të vlerësuar besimin e tyre në procesin zgjedhor dhe për të dëgjuar çdo njoftim për parregullsi. Të gjitha mendimet duhet të merren në shqyrtim sapo të sigurohet besueshmëria e tyre. Vëzhguesit duhet të dinë se ka disa persona që mund të përpiqen ta manipulojnë informacionin për qëllimet e tyre dhe si rrjedhojë duhet ta përdorin gjykimin e tyre për të siguruar një vlerësim të ekuilibruar të një situatë. Është mirë që të bisedohet me përfaqësues nga secili grup sa herë të krijohet mundësia.

Kur vëzhgojmë proceset e votimit dhe numërimit, duhen patur parasysh çështjet e mëposhtme:

➔ ***Kushtet e qendrës së votimit:***

- A gjendet lehtë qendra e votimit?
- A është e vështirë të mbërrihet në qendrën e votimit?
- A ka ndonjë shenjë të materialeve të fushatës apo veprimtarisë së fushatës në, mbi, apo rreth qendrës së votimit?
- A ka ndonjë njoftim për frikësim, mitmarrje apo trazirë?
- A ka ndonjë person të paautorizuar të pranishëm në qendrën e votimit?
- A ka anëtarë të personelit të sigurimit që sillen në mënyrë të pahijshme?
- A janë nxitur zgjedhësit të votojnë në një mënyrë të caktuar?

➔ ***Punonjësit e zgjedhjeve:***

- A duken të jenë të mirë trainuar punonjësit e qendrës së votimit mirë dhe a i njohin ata procedurat e votimit dhe të numërimit?
- A duken punonjësit të lirshëm për të biseduar në lidhje me detyrat e tyre?
- A janë ata të paanshëm gjatë kryerjes së detyrave të tyre?
- A janë të gjithë anëtarët e caktuar të pranishëm, apo ka ndonjë prej tyre që është penguar të kryejë detyrën e tij në komisionin e qendrës së votimit?

➔ ***Materialet:***

- A ka materiale të mjaftueshme për votim?
- A kanë qenë të siguruara materialet e votimit gjatë kohës midis dorëzimit të tyre dhe hapjes së qendrës së votimit?

Vëmendje e veçantë u duhet kushtuar **procedurave të veçanta të votimit**, ku futen votimi përpara kohe, votimi lëvizës dhe votimi i ushtarëve, i të burgosurve dhe i pacientëve në spitale:

- A është votimi përpara kohe i rregulluar, i sigurtë dhe transparent aq sa duhet?
- A është rregulluar si duhet përdorimi i kutisë lëvizëse të votimit?
- Në rast se përdoret një listë suplementare zgjedhësish për zgjedhësit e sëmurë dhe të moshuar që votojnë në shtëpi, a ka në këtë listë një numër jashtëzakonisht të madh emrash?
- A u janë dhënë ushtarëve, të burgosurve dhe pacientëve në spitale materiale të mjaftueshme zgjedhore në mënyrë që ata të dinë si të bëjnë zgjedhjen e tyre?
- A janë bërë rregullime të veçanta për ushtarët, të burgosurit ose pacientët në spitale?
- A janë krijuar kushtet e mjaftueshme për ushtarët, të burgosurit apo pacientët në spitale për të votuar në mënyrë të fshehtë, pa asnjë shtrëngim?
- A u është kërkuar ushtarëve të votojnë në prani të oficerëve të tyre?
- A i udhëzojnë oficerët ushtarët se si të votojnë?

➔ **Procedurat e numërimit:**

- A kryhet numërimi i votave në mënyrë transparente?
- A janë vëzhguesit, ndërmjetësit dhe përfaqësuesit e partive dhe kandidatëve në gjendje të ndjekin të gjitha aspektet e numërimit?
- Si bëhet krahasimi midis numrit të zgjedhësve të regjistruar që figurojnë se kanë votuar me numrin e votave të hedhuara aktualisht në kutinë e votimit?
- A numërohen fletët e votimit në mënyrë të rregullt dhe të sigurtë?
- A sigurohen, anulohen apo eliminohen fletët e votimit të papërdorura?
- A bëjnë zyrtarët zgjedhorë ndonjë shenjë apo shënim mbi fletët e votimit?
- A gjykohen dhe veçohen fletët e votimit të pavlefshme nga fletët e tjera të votimit ashtu si duhet dhe në vazhdimësi?
- A duket numri i fletëve të pavlefshme jashtëzakonisht i lartë?
- A trajtohen ankesat në mënyrë të kënaqëshme?
- A ka ndonjë ndërmjetës apo përfaqësues partie që përpiket të ndërhyjë apo aktualisht po ndërhyjnë në procesin e numërimit?
- A ka persona të paautorizuar të pranishëm dhe në rast se po, çfarë roli luajnë ata në proces?

➔ **Përfundimi dhe transportimi i rezultateve:**

- A janë plotësuar si duhet protokollet e rezultateve në përfundim të numërimit dhe a janë nënshkruar ato nga të gjithë personat e autorizuar?
- A lejohen vëzhguesit, apo agjentët dhe përfaqësuesit e partive/kandidatëve të marrin kopje të protokolleve të rezultateve në përfundim të numërimit?
- A njoftohen rezultatet publikisht dhe a afishohet një kopje e protokollit të rezultateve?

Ku të jetë e mundur, pyetje të pakufizuara si “Si veproi komisioni i zgjedhjeve me njerëzit emrat e të cilëve nuk ishin në listat e zgjedhësve?” duhen shmangur. Një tekst i gjatë është vështirë të analizohet, veçanërisht kur ka mijëra formularë për t’u lexuar. Nëse përdoren pyetje të hapura, atëherë vëzhguesve u duhen dhënë një numër përgjigjesh të paracaktuara e të mos i lihet gjithshka komenteve të tyre me shkrim. Një shembull për këtë është treguar në faqen pasardhëse:

Shembull 2:
Pyetje të para-koduara

Përsë nuk u hap në kohë qendra e votimit? [Ju lutemi shënoni në kutizë përgjigjen/t e duhura]

- Mungonin materialet zgjedhore? Nuk ishte numri i domosdoshëm i anëtarëve të komisionit të qendrës së votimit?
- Kërcënohej siguria e qendrës së votimit? Nuk u lejua të hynte në godinë Komisioni i Zgjedhjeve?
- Të tjera (Ju lutemi me shkrim) ? _____

Një lloj i tretë pyetjesh që mund të jenë të vlefshme është t’u kërkosh vëzhguesve të japin gjykimin e tyre mbi një problem duke zgjedhur përcaktimin në formular, që pasqyron më së miri atë që ata kanë vëzhguar. Një shembull të kësaj lloj pyetjeje mund ta shihni më poshtë. Kjo mund të jetë veçanërisht me vlerë për bërjen e një vlerësimi të përgjithshëm për qendrën e votimit. Në përgjithësi, hartuesit e formularëve duhet të shmangin përdorimin e një numri tek përcaktimesh/përgjigjesh, ose vlerësimet në bazë të një shkallëzimi prej tri ose pesë pikësh, pasi përvoja ka treguar se vëzhguesit tentojnë ta vendosin zgjedhjen e tyre në pikën e mesit të shkallëzimit.

Shembulli 3:
Pyetje me katër shkallëzime

Si do ta klasifikonit zhvillimin e përgjithshëm të votimit në këtë qendër votimi?

[Ju lutemi rrrumbullakosni atë që e përfaqëson shkallëzime më mirë mendimin tuaj]

- | | | | |
|---------------|-----------------------|---------------------------------|------------------------|
| Asnjë shkelje | Disa shkelje të vogla | Numër i vogël shkeljesh serioze | Shumë shkelje të rënda |
|---------------|-----------------------|---------------------------------|------------------------|

B. NXJERRJA PARALELE E REZULTATEVE¹⁶

Qëllimi i një nxjerrjeje paralele të rezultateve (Parallel Vote Tabulation PVT) është që partitë politike, kandidatët dhe publiku të kenë informacionin e besueshëm që ndihmon në vlerësimin e legjitimitetit të rezultateve. Marrja në kohë e vendimit nëse duhet përdorur metoda PVT-s është jashtëzakonisht e rëndësishme, pasi organizimi i saj ndikon të gjithë mënyrën e shpërndarjen së vëzhguesve në të gjithë vendin.

Megjithëse më shumë parapëlqehet organizimi i grumbullimit të rezultateve nga të gjitha qendrat e votimit, në praktikë, nevoja e madhe për shumë personel dhe sisteme komunikimi mund ta pengojë realizimin e një veprimi të tillë. Në të tilla raste, përdorimi si model i një numri qendrash votimi, të përcaktuara shkencërisht si të tilla, mund të japë rezultate shumë të sakta dhe, nëse bëhet ashtu siç duhet, mund t'u sigurojë anëtarëve të një grupi vëzhguesish vendorë mundësinë për të bërë parashikime të besueshme në lidhje me rezultatet e përgjithshme.

Një grup vëzhguesish vendorë duhet të konsultohet me një ekspert të shkencave sociale, një statisticien apo organizatë për anketime publike kur i duhet të përcaktojë madhësinë dhe përbërjen e numrit përfaqësues të zgjedhur në mënyrë të rastësishme. Përvoja tregon se atje ku ka informacion të pakët demografik dhe popullsia është krejtësisht e ndryshme, tendenca është që të përdoret një kampion përfaqësimi relativisht i lartë, 10 për qind e qendrave të votimit. Kur ndodh e kundërta, mund të përdoret një numër më i vogël i cili jep rezultate të besueshme e të sakta për zgjedhjet kombëtare. Në rast se vëzhgohen zgjedhje bashkiake apo zgjedhje të bazuara kryesisht në zona zgjedhore që përdorin sistemin majoritar të votimit atëherë duhet treguar kujdes i veçantë për madhësinë dhe përbërjen e kampionit përfaqësues në nivel zone apo rrethi zgjedhor sepse duhen marrë parasysh edhe nuancat lokale.

Për të përgatitur një program kompjuterik dhe për të zgjedhur qendrat e votimit që do të përfshihen në kampionin e rastësishëm për trajtim, ekipi i hartuesve të PVT-ës do të duhet të ketë informacion të saktë rreth numrit, vendndodhjes dhe madhësisë së elektoratit në të gjitha qendrat e votimit. Rezultatet nga qendrat e votimit të zgjedhura për nxjerrje paralele të rezultateve (PVT) duhet të regjistrohen me saktësi nga vëzhguesit në një formular raportimi të thjeshtë një-fletësh.

¹⁶ Për më shumë informacion mbi nxjerrjen paralele të rezultateve, shih *The Quick Count and Election Observation, An NDI Guide for Civic Organizations and Political Parties*, botuar nga Instituti Demokratik Kombëtar për Çështjet Ndërkombëtare (NDI) në 2002.

VËZHgues VENDORË SËRBË KRYEJNË NXJERRJE PARALELE REZULTATESH NË KUSHTE TË PAFAVORSHME

Në vitet midis 1997 dhe 2000, CeSID, një OJO serbe, u pengua nga autoritetet që të vëzhgonte zgjedhjet në Serbi. Përballë kësaj situatë, CeSID vendosi të organizonte një nxjerrje paralele rezultatesh gjatë zgjedhjeve federative në Shtator, 2000, duke i vendosur vullnetarët jashtë qendrave të votimit për të kontaktuar me ndërmjetësit e partive dhe për të siguruar rezultatet pasi ato të afishoheshin publikisht pas numërimit.

Pas një sulmi të policisë në selinë e tyre dhe sulmeve të mëvonshme në zyrat rajonale disa javë para ditës së votimit dhe duke patur parasysh sigurinë e vullnetarëve të tyre, CeSID vendosi t'i kryente përgatitjet për nxjerrjen paralele të rezultateve me shumë kujdes dhe pa rënë në sy. U instalua një metodë e ndërlikuar, por shumë e sigurtë, komunikimi nëpërmjet telefonit dhe Internetit, me servera backup. Udhëzimet përfundimtare dhe formularët u shpërndanë vetëm pak kohë para ditës së zgjedhjeve.

Pavarësisht nga përpjekjet për ta minuar punën e saj, CeSID arriti të japë rezultate prej më shumë se 1,096 qendra votimi që në 4.30 të mëngjesit të ditës së nesërme të zgjedhjeve. Këto rezultate parashikonin një fitore për Koshtunicën dhe kundërshtonin rezultatet e botuara nga Komisioni Federativ i Zgjedhjeve, sipas të cilave Miloševići ishte përpara me me vota dhe se nevojitej mbajtja e një raundi të dytë zgjedhesh. Publiku serb nuk i pranoi rezultatet e Komisionit Federativ dhe si rezultat Komisioni deklaroi rezultate të tjera sipas të cilave Koshtunica kishte fituar postin e presidentit.

- Ë Sigurohuni se e njihni mirë mekanizmin për nxjerrjen e rezultateve dhe hedhjen e tyre në kompjuter
- Ë Caktoni një sistem për monitorimin e nxjerrjes dhe përcjelljes së rezultateve në të gjitha nivelet
- Ë Monitoroni me kujdes zhvillimet pas ditës së zgjedhjeve, veçanërisht ndonjë kundërshtim të ligjshëm të rezultatit të zgjedhjeve

A. RËNDËSIA E MONITORIMIT TË NXJERRJES SË REZULTATEVE

Gjatë nxjerrjes dhe hedhjes së rezultateve ka veçanërisht shanse për gabime dhe manipulim. Si rrjedhim, një grup vëzhguesish vendorë duhet t'i monitorojë me kujdes dhe sistematikisht këto elemente të procesit zgjedhor. Në fakt, vetë prania e vëzhguesve gjatë nxjerrjes dhe dhënies së rezultateve mund të jetë një mjet parandalues për manipulimin.

Disa shtete botojnë të dhëna për pjesmarrjen në votim në ditën e votimit, shpesh duke përdorur sistemet kompjuterike për regjistrimin e informacionit. Një grup vëzhguesish vendorë duhet të përpiqet të sigurojë kopje të këtyre të dhënave për të verifikuar më vonë nëse ka patur ndonjë rritje të menjëhershme dramatike të pjesëmarrjes dhe nëse të dhënat në lidhje me të përputheshin me të dhënat e protokolleve të rezultateve të qendrave të votimit.

Rezultatet e numërimit në një qendër votimi normalisht i kalohen një komisioni rajonal zgjedhës dhe rezultatet rajonale grumbullohen dhe i kalohen Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në nivel kombëtar. Vëzhguesit vendorë duhet të jenë të sigurtë se ai e kuptojnë mirë mënyrën e kalimit dhe grumbullimit të rezultateve. Ata duhet të jenë të pranishëm në çdo nivel ku nxirren rezultatet, duke caktuar ekipe të trainuar posaçërisht, në bazë të një sistemi operimi me turne. Ku të jetë e mundur, rezultatet duhet të shoqërohen gjatë kalimit nga një nivel në tjetrin.

lacionin zgjedhor. Çdo vonesë apo mospërputhje e pajustificuar në lidhje me grumbullimin, verifikimin dhe njoftimin e rezultateve përfundimtare duhet të vihet në dukje dhe të hetohet.

Verifikimi i rezultateve nga një grup vëzhguesisht vendorë mund të shërbejë për rritjen e besimit publik në rezultatin e një procesi zgjedhor, ose mund të verë në pikëpyetje rezultatet në rast se zbulohen anomali.

Në shumicën e vendeve të OSBE-së, ligji parashikon një periudhë kohe brenda së cilës partitë dhe kandidatët mund të kundërshtojnë rezultatin e një zgjedhjeje. Këto mosmarrëveshje duhet të monitorohen me kujdes duke përdorur metodologjinë e përcaktuar në Kapitullin 4, pas ato janë gjithmonë më të diskutueshmet. Grupet e vëzhguesve vendorë duhet të monitorojnë zhvillimin e një rasti në gjykatë dhe të mos bazohen në informacionin nga mjetet e informacionit apo palët në proces gjyqësor.

Në periudhën paszgjedhore, vëzhguesit duhet të përpiqen të gjejnë të dhëna treguese për problemet e shfaqura në proces, si p.sh. mosrespektimi i afateve, procedura të parregullta vendim-marrëse, vonesa në hetimin e pretendimeve për parregullsi, transparencë e pamjaftueshme për vëzhguesit apo partitë politike, etj. Ata duhet të hetojnë gjithashtu ndonjë hakmarrje apo kërcënim për hakmarrje drejtuar qytetarëve për pjesëmarrjen e tyre në një zgjedhje apo për votimin e tyre në favor të një konkurruesi të caktuar në zgjedhje dhe duhet të kontrollojnë nëse ka ndonjë tregues për mjete të caktuara informacioni që parapërgatisin publikun për një rezultat të manipuluar.

Një grup vëzhguesish vendorë duhet të përgatitet të hetojë çdo problem që tregon se po ndiqet një model sistematik manipulimi të qëllimshëm ose që mund të ndikojë në mënyrë të ndjeshme në rezultatin e zgjedhjeve. Për këtë qëllim, ekipe të posaçme mund të angazhohen në hetimin e rasteve të veçanta shqetësuese. Një grup vëzhguesish vendorë duhet të jetë gjithashtu i gatshëm të takohet me partitë politike, me elemente të tjerë brenda shoqërisë civile dhe me zgjedhës për të dëgjuar ndonjë shqetësim që ata mund të kenë, për të marrë ndonjë dëshmi për manipulim, apo për të kërkuar ndonjë informacion shtesë që mund të nevojitet.

- Ë Paracaktoni një strukturë raportimi që mundëson përcaktimin e çështjeve kryesore dhe transmetimin e informacionit përkatës brenda grupit të vëzhgimit në kohën e duhur
- Caktoni formate raportesh, përfshi këtu raportet javore, raportet për incidente, raportet për ngjarjet gjatë fushatës dhe raportet për ditën e zgjedhjeve
- Sigurohuni që deklaratat dhe raportet janë të sakta, të prodhuara në mënyrë profesionale dhe të shpërndara pranë organizatave dhe individëve përkatës

A. RËNDËSIA E RAPORTIMIT

Raportimi është një aspekt i rëndësishëm i vëzhgimit të zgjedhjeve. Ai jep një dëshmi publike se çfarë është vëzhguar dhe shërben si një referencë për t'u përdorur në zgjedhjet e ardhshme. Për të mundësuar dhënien e njoftimeve publike, do të ishte e nevojshme hartimi dhe analiza e raporteve të brendshme të rregullta. Kjo do të kërkonte një organizim dhe zhvillim të kujdesshëm të sistemeve të raportimit.

Një grup vëzhguesish vendorë duhet të vendosë nëse ai ka për qëllim të japë njoftime publike përpara përfundimit të zgjedhjeve, apo vetëm pas ditës së zgjedhjeve. Raportimi parazgjedhor i jep munësinë një grupi të komentojë në mënyrë konstruktive zhvillimin e procesit, duke e bërë një gjë të tillë, ose në një moment të përshtatshëm, ose në mënyrë të rregullt. Shumë grupe vëzhguesish vendorë ndjekin këtë metodë. Megjithatë, të tjerë parapëlqejnë të mos japin gjykimin e tyre për procesin deri në përfundim të zgjedhjeve. Pavarësisht se cilën metodë ndjek një grup vëzhguesish vendorë, duhet te synojë të bëjë një deklaratë paraprake dhe një raport përfundimtar pas zgjedhjeve. Këto do të jenë vlerësimi i tij përfundimtar për procesin zgjedhor.

- **Ë Mjetet e informacionit:** si kanë qenë njoftimet e mjeteve rajonale të informacionit rreth fushatës zgjedhore, nëse këto mjete informacioni kanë lejuar akses të arësyeshem për konkurruesit; nëse mbulimi me njoftime ka qenë i ekuilibruar; dhe se si kanë reaguar partitë, kandidatët dhe publiku ndaj këtij mbulimi;
- **Ë Administrata shtetërore:** nëse institucionet publike janë asnjëherë në fushatë, ndonjë njoftim për organizata shtetërore që pengojnë fushatat apo bëjnë trajtime favorizuese për partitë/kandidatët dhe mbështetësit e tyre dhe nëse organet publike i përmbahen ligjit;
- **Ë Kërcënimi/Konfliktet me zgjedhësit:** Nëse ka patur ndonjë incident kërcënimi a shtrëngimi të zgjedhësve nga partitë apo të tjerë (duhen cituar shembuj të veçantë), nëse ka ndonjë tregues se mund të ketë konflikt dhe në rast se po, nëse është bërë ndonjë gjë për parandalimin e tij, e konflikteve të tilla dhe nëse ka patur shembull konflikti/dhune;
- **Ë Pjesëmarrja e grave:** nëse gratë kanë patur një diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në procesin zgjedhor apo kanë ngritur çështje të veçanta me interes, nëse ata kanë marrë pjesë masivisht në proces;
- **Ë Pjesëmarrja e pakicave kombëtare:** në qoftë se në zonë ka patur ndonjë komunitet të një pakice kombëtare, nëse ata nuk janë penguar për të patur akses në proces, nëse ata marrin pjesë në të dhe nëse janë diskutuar çështje të veçanta që janë me shqetësuese për ta;
- **Ë Çështje të tjera që duhen shënuar.**

Raporti duhet të jetë i përmbledhur, i shkruar qartë dhe i bazuar në fakte. Ai duhet të shmangë spekulimin dhe të njoftojë atë që është vëzhguar dhe çfarë i është raportuar monitoruesit, duke bërë një dallim të kujdesshem midis të dyjave. Në rast se është paraqitur një pretendim, monitoruesi duhet të tregojë nëse një burim tjetër ka verifikuar apo ka sjellë argumenta për këtë pretendimin. Raportet duhet të komunikohen në mënyrë të sigurtë tek një person i posaçëm në Njësinë e Vëzhgimit, Koordinimit dhe Analizës në zyrën qendrore, i cili duhet të ngarkohet me leximin, krahasimin, klasifikimin dhe përmbledhjen e pretendimeve. Në qoftë se ka çështje që kërkojnë një hetim të mëtejshëm, ky person duhet të jetë pika kryesore e kontaktit. Po të jetë e mundur, monitoruesit rajonalë duhet të udhëtojnë deri në zyrën qendrore për raportime të rregullta. Në disa raste, mund të jetë me dobi qarkullimi i raporteve përmbledhëse tek monitoruesit në mënyrë që ata të kenë idenë rreth ngjarjeve në vend dhe të mund të përcaktojnë mënyrat e sjelljes.

2. Incidentet që vlen të përmenden:

- Hollësi për ndonjë incident të veçantë që ka shkaktuar shqetësim të konsiderueshëm, veçanërisht rastet e dhunës që kanë lidhje me zgjedhjet.

3. Përfundim - vlerësim i përgjithshëm i zgjedhjeve:

- Vlerësimi për zhvillimin e zgjedhjeve nisur nga respektimi i angazhimeve ndërkombëtare, përmbushja e standarteve për zgjedhje demokratike dhe e përcaktimeve në legjislacionet kombëtare përkatëse, veçanërisht të atyre që parashikohen nga ligji për zgjedhjet dhe kushtetuta.

Deklarata paraprake paszgjedhore duhet të konsiderohet si një nga konstatimet dhe konkluzionet më të rëndësishme të një grupi vëzhguesish vendorë. Prandaj, ai duhet të jetë i përmbledhur dhe i qartë, ku të dalin në pah qartë pikat kryesore. Hollësira pafund dhe çështje jo të rëndësishme duhen shmangur. Një përshkrim më i gjatë dhe shembujt duhen ruajtur për raportin përfundimtar.

Së fundi, një grup vëzhguesish duhet të ekuilibrojë presionet e mjeteve të informacionit për një koment të parakohshëm para se ai të ketë grumbulluar konstatimet e tij dhe të ketë përfunduar analizën. Shumë elementë të deklaratës në lidhje me periudhën parazgjedhore mund të përgatiten para ditës së zgjedhjeve, duke i shtuar konkluzionet mbi votimin, numërimin, dhe nxjerrjen e tabelave të rezultateve sapo të analizohen raportet e këtyre aspekteve të procesit. Një grup vëzhguesish vendorë duhet të përcaktojë një kuadër raportimi që lejon bërjen në kohë të deklaratës paraprake. Ndërsa grupi nuk duhet të nxitohet në dhënien e një deklarate të pamatur, ai duhet të dijë se konkluzionet e tij do të shihen me vëmendje të madhe dhe do të kenë një ndikim maksimal në kohën kur publiku dhe mjetet e informacionit janë shumë të interesuar, p.sh., në ditët menjëherë pas zgjedhjeve.

paszgjedhor për një numër pjesmarrësish të interesuar, përfshi autoritetet, ligjvënësit dhe administratën zgjedhore.

F. SHPËRNDARJA E RAPORTEVE

Si deklarata ashtu dhe raportet duhet të bëhen në gjuhën(t) kryesore të vendit dhe po të jetë e mundur edhe në gjuhët e pakicave dhe në anglisht për një shpërndarje të tyre tek të huajt. Deklaratat dhe raportet duhet t'u shpërndahen mjeteve të informacionit, vendase dhe të huaj, organizatave ndërkombëtare dhe OJF-ve, ambasadave, autoriteteve vendase, partive politike, kandidatëve, donatorëve dhe komunitetit ndërkombëtar. Deklaratat dhe raportet duhet të afishohen në faqen e internetit të grupit të vëzhguesve vendorë.

e asistencës, duke u përpjekur të lehtësoje dhe shtojë zbatimin e angazhimeve të OSBE-se nga Shtetet pjesëmarrëse të saj dhe zhvillimin e strukturave demokratike.

ODIHR nxit mbrojtjen e të drejtave të njeriut nëpërmjet projekteve të asistencës teknike dhe trainimit për çështje që lidhen me dimensionin njerëzor. Ajo bën kërkime dhe përgatit raporte për tema të ndryshme për të drejtat e njeriut. Përveç kësaj, Zyra organizon disa takime në vit për të kontrolluar zbatimin nga Shtetet pjesëmarrëse të angazhimeve të OSBE-së në lidhje me të drejtat e njeriut. Në veprimtaritë e saj kundër terrorizmit, ODIHR po punon për të rritur ndërgjegjësimin ndaj çështjeve të këtij dimensionin njerëzor dhe po realizon projekte që në themel trajtojnë faktorët që shkaktojnë terrorizmin.

ODIHR jep këshillim për Shtetet pjesëmarrëse për politikat e tyre mbi komunitetet roma dhe sinti. Ajo nxit krijimin e kapaciteteve dhe lidhjet në rrjet midis komuniteteve roma dhe sinti dhe inkurajon pjesëmarrjen e përfaqësuesve të këtyre komuniteteve në organet që merren me hartimin e politikave publike. Zyra vepron gjithashtu si një doganë për shkëmbimin e informacionit rreth çështjeve të komuniteteve roma dhe sinti midis aktorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Të gjitha veprimtaritë e ODIHR-it zhvillohen në koordinim dhe bashkëpunim të ngushtë me institucionet dhe veprimet në terren të OSBE-së, si dhe me organizatat e tjera ndërkombëtare.

Më shumë informacion mund të gjeni në faqen e internetit të ODIHR (www.osce.org/odihp).

